

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7345 E hënë 6 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në 'Deutsche Welle'
Revolucioni rus i Tetorit konsiderohet si fitorja e punëtorëve dhe bujqve ndaj sundimit të carëve, por ajo që shumë pak e dinë është se në të ishte i përfshirë edhe...
Vijon në faqen 21

Nga VOLKER WAGENER
Si i mbështeti perandori gjerman bolshevikët


Opinion i Ditës
Të ndjekësh emisione a programe televizive që kanë në qendër debatin për probleme të ndryshme që shqetësojnë shoqërinë tonë është kthyer në një sfidë...
Vijon në faqen 12

Nga VALBONA NATHANAILI
Leksion rreth radarëve që përdoren në ushtri



Anëtari i kryesisë së PD: Kush na dëmtoi
Jamarbër Malltezi: Pse humbëm në 25 qershor, opozita kundra pushtetit

"Funksionarë të lartë dëmtuan Partinë Demokratike në zgjedhje. Jemi në proces analize dhe konsultimesh"
Nga VALENTINA MADANI
PD është përfshirë në proces-analizë dhe konsultë të gjerë me të gjitha strukturat e saj pas humbjes së zgjedhjeve të 25 qershorit. Jamarbër Malltezi, anëtar i kryesisë dhe Këshillit Kombëtar të PD-së, është pjesë e grupeve të punës të shpërndara në...
Në faqen 6

HERMES BEQIRI, 23 VJEÇ, HUMBI JETEN NE SPITAL 24 ORE PAS ATENTATIT SHERRI PER NJE KAPELE, VRITET I RIU SHKODRANË

Si nisi konflikti mes dy 17-vjeçarëve Elvis Hoxha e Ditmir Harifi me viktimën. Pranga autorit. Jeta e mëparshme e djemve shkodranë



(Në foto) Viktima Hermes Beqiri. Elvis Hoxha, autori i dyshuar për vrasjen e Hermes Beqirit



DEKLARATAT PER LU
Agjentët e FBI në Tiranë, Edi Rama: Plan sekret kundra 'kriminalit me kollare'
Në faqen 5

KONVENTA E LSI
Monika Kryemadhi paralajmëron për protesta masive: S'ka më kohë, përballje
Në faqen 4

HETIMET E PROKURORISE
Zbardhen pasuritë e dy fiseve më të mëdha në Elbasan, Çapjave e Çelajve
Në faqen 8

DOKUMENTET
Ish-të përndjekurit, lista e përfituesve të dëmshpërblimit të kështit të II
Në faqen 18-20

KONKURRIMI NE 14 DEGE

Juridiku shpall fituesit, lista me emrat në masterin shkencor e profesional
Në faqen 10-11

MSH: Mamot e lëvizshme, 3 mijë ekzaminime, Lezha me numrin më të lartë të diagnostikimeve
Albana Duni: Mëlçia e dhjamosur, ja shkaku kryesor
"Ja cilat janë medikamentet që zhvillojnë sëmundjen, ngatërrohet diagnoza"
Nga VOLTIZA DURO
Steatohepatiti joalkolik, Si njohur si NASH, apo mëlçia e dhjamosur ka filluar të haset shpesh në dyert e spitaleve në vendin tonë. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon se faktori kryesor i kësaj sëmundjeje është obeziteti. Sipas saj, kategoria më e prekur nga dhjamosja e mëlçisë janë femrat obeze me rritje të sasisë së kolesterolit në gjak, por edhe meshkujt e dobët. Mjekja thekson...
Suplement



ÇESHTJA "TAHIRI" HETIMET

Reagon Policia e Shtetit: Akuzat politike, pa bazë ligjore

Iu gjetën në makinë 863 000 euro, nën hetim pasuritë e Orest Sotës

Prokuroria, dyshime për sigurimin e të ardhurave

Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të he tojë pasurinë e biznesmenit Orest Sota për të verifikuar mënyrën sesi ka gjeneruar 863 mijë euro kesh të pashoqëruara me asnjë faturë apo mandat. Gjithashtu, 25-vjeçari duhet të justifikojë edhe dy patenta për lundrim të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Hetimi për paratë e gjetura pritet t'i kalojë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pasi Prokuroria e Elbasanit nuk ka kompetencën për të zhvilluar hetimin pasuror. I ri nga Vlora, pronar i një firme private në fushën e betonit, është shprehur para trupës gjyqësore se paratë do t'i përdorte për likuidimin e disa faturave. Më pas, i ati i Sotës ka reaguar duke thënë se shuma e gjetur në makinë do të përdorej si garanci për një marrëveshje tregtare në "Kurum". Pritet që hetuesit të verifikojnë firmën e ndërtimit dhe të ardhurat e sjella prej saj. Prokuroria dyshon se kjo shumë mund të ketë ardhur nga aktivitetet të paligjshme, ose nuk është deklaruar për t'u fshehur tatimeve. I ati i Sotës mësohet se është shprehur se kjo valutë buron nga të ardhurat e tij personale dhe kursimet në vite dhe do të përdoreshin për blerjen e hekurit të kompania "Kurum". Ndërkohë, përmes një njoftimi të shpërndarë për mediat Policia e Shtetit rishpreh keqardhjen për akuzat mbi ndalimin e Orest Sotës, të cilat thotë se janë politike dhe pa bazë ligjore apo faktike. "Pretendimet e opozitës janë spekulime politike dhe s'kanë asnjë lidhje me të vërtetën e punës së bërë nga Policia e Shtetit", thuhet në njoftim. Sipas policisë, uniformat blu kanë ndaluar në flagrancë autorin dhe kanë mbajtur të plotë procesverbalin në vendngjarje dhe dosjen e plotë ia kanë përcjellë menjëherë Prokurorisë.



Biznesmeni Orest Sota

NJOFTIMI I POLICISË

"Pretendimet e opozitës janë spekulime politike dhe s'kanë asnjë lidhje me të vërtetën e punës së bërë nga Policia e Shtetit", thuhet në njoftim. Sipas policisë, uniformat blu kanë ndaluar në flagrancë autorin dhe kanë mbajtur të plotë procesverbalin në vendngjarje dhe dosjen e plotë ia kanë përcjellë menjëherë Prokurorisë.



Patentat e Saimir Tahirit, që u gjetën në makinën e biznesmenit

PATENTAT

25-vjeçari ka dëshmuar se eurot janë të tijat. Ai tha se nuk mund të shpjegonte se si dy patentat e Saimir Tahirit ishin në makinën e tij. "Ndoshta i ka lënë shoferi i Saimir Tahirit, të cilin e kam shok. Ai ishte në makinën time një dite para se të arrestohesha" - Sota.

"Paratë, paradhënie për kompaninë "Kurum"

Babai i biznesmenit: E vërteta për 800 mijë eurot që iu gjetën djalit

Lefter Sota, babai i Orest Sotës, të cilin u gjetën më shumë se 800 mijë euro nga ana e policisë, ka reaguar për të sqaruar situatën. Përmes "Tema", ai thotë se kjo shumë do të përdorej si garanci për një marrëveshje tregtare me "Kurum".

REAGIMI I PLOTË I BIZNESMENIT SOTA

Infomroj opinionin publik dhe mediat lidhur me arrestimin e djalit tim, Orest Sota se, në datën 1 nëntor 2017 kam dërguar djalin tim Orest Sotës të çojë pranë kompanisë "Kurum" sh.a, një sasi eurosh në kesh, si garanci për një të tretën e shumës së një kontrate për 4000 tonë hekur ndërrimi. Ashtu siç kam deklaruar edhe pranë oficerit të policisë, bazuar në normat tregtare për mbajtjen e kontratës, kjo shumë do të shërbente si garanci e kthyeshme,



Foto ilustruese

mbasi të ishte kryer pagesa e plotë në bankë. Njoftoj se kjo sasi valutë buron nga të ardhurat e mia personale e kursimet në vite. Unë kam

filluar aktivitetin tregtar në vitin 1992. Objekti tregtar i shoqërisë është tregtimi i materialeve të ndërtimit, hekurit të ndërrimit, për-

punimi i tij, si dhe përpunimi i skrapit dhe metaleve me ngjyra. Kërkoj ndjesë publikut dhe Policisë së Shtetit për mosrespektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga Oresti. Deklaroj nën përgjegjësi penale dhe publike se shuma e valutës është e imja, duke provuar përpara organit të akuzës. Falënderoj Policinë e Shtetit dhe organin e akuzës për profesionalizmin e treguar. Respektoj gjithë spektrin politik dhe mediat për opinionet e tyre.

Ju lutem të respektoni shqetësimin tonë dhe të lemë drejtësinë të na gjykojë. Me respekt, Lefter Sota!

DËSHMIA E OREST SOTËS

Më herët 25-vjeçari ka dëshmuar se eurot janë të tijat. Ai tha se nuk mund të shpjegonte se si dy patentat e Saimir Tahirit ishin në makinën e tij. "Ndoshta i ka lënë shoferi i Saimir Tahirit, të cilin e kam

shok. Ai ishte në makinën time një dite para se të arrestohesha", tha 25-vjeçari. Trupi gjyqësor, i kryesuar nga gjyqtarja Miranda Konica, la në fuqi kërkesën e Prokurorisë, e cila kërkoi masën e sigurisë "arrest me burg". Prokurorja Erida Kokonozi

gjatë seancës gjyqësore kërkoi gjithashtu edhe sekuestro të eurove deri në paraqitjen e faturave, të cilat do të faktojnë pretendimin e të arrestuarit se kjo shumë do të derdhej konform ligjit për disa pagesa hekurit, që i akuzuari do të kryente pasi malli ishte blerë më parë.

NGJARJA



U kap me një sasi të madhe parash, në pranga 25-vjeçari

Mbrëmjen e së mërkurës është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Orest Sota, 25 vjeç, banues në Tiranë, administrator i një subjekti privat sh.p.k. Sipas policisë, arrestimi i tij është bërë pasi më datë 1 nëntor, në rrugën nacionale, në fshatin Balldren, u kap duke drejtuar pa leje drejtimit mjetin "Land Rover". Ndërsa nga kontrolli në mjetin u gjetën e bllokuan një sasi e madhe eurosh, i cili pretendonte se do t'i përdorte për likuidimin e faturave, por të pashoqëruara me dokumentin e origjinës, si dhe dy patenta për drejtimin e mjeteve lundruese, të cilat mbanin emrin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri.



Ish-ministri, dy herë jashtë shtetit me të riun që iu gjetën 800 mijë euro në makinë

Basha publikon datat: Tahiri dhe Sota kanë udhëtuar bashkë

"Rama po përpiqet të fshehë provat"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, publikoi dje fakte të reja lidhur me përfshirjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri me grupet kriminale. Konkretisht, z.Basha zbardhi dy udhëtime jashtë shtetit të Tahirit me biznesmenin Sota, ndërsa jep edhe datat e këtyre udhëtimeve. Më 2 gusht, Tahiri dhe Sota kanë udhëtuar drejt Italisë; më 1 shtator kanë dalë nga Shqipëria përmes doganës së Muriqanit dhe më 6 shtator, Orest Sota ka dalë sërish nga vendi ynë duke përdorur automjetin e Saimir Tahirit. Në denoncimin e tij, Lulzim Basha akuzon kryeministrin Edi Rama se po mbron Tahirin dhe po përpiqet të fshehin provat, ndërsa paralajmëron se të tjera të dhëna do të publikohen së shpejti.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

UDHËTIMET

Sipas Bashës, më 2 gusht Tahiri dhe Sota kanë udhëtuar drejt Italisë; më 1 shtator kanë dalë nga Shqipëria përmes doganës së Muriqanit dhe më 6 shtator, Sota ka dalë sërish nga vendi duke përdorur automjetin e Tahirit.

Berisha: Tahiri njihej me biznesmenin e arrestuar

Ish-kryeministri Sali Berisha postoi dje një video, në të cilën tregon se ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri njihej me biznesmenin e arrestuar nga policia e Elbasanit me 863 mijë euro në makinë dhe dy patentat e Tahirit. Në një postimin në "Facebook", Berisha shkruan se videon ia ka dërguar qytetari dixhital. Ish-ministri Tahiri shfaqet përkrah kreut të Policisë së Shtetit, Haki Çako dhe biznesmenit Orest Sota. "Qytetari dixhital përshëndet: Mirëmëngjes Noriega ynë! Ja dhe dy miqtë që nuk e njohin njëri-tjetrin, Saimir Trafiku dhe Orest Sota. Shikoni videon e mëposhtme sa të panjohur janë!sb", - shkruan Berisha.



"Tahiri", Balla-Bashës: Shpif për policinë

Pas akuzave të kreu demokrat, Lulzim Basha, ndaj Ramës e Tahirit, tekta shkruan se këtij të fundit po i del boja gjithnjë e më shumë si i lidhur me krimin e përfutuesit e tij, reagoi deputeti i PS, Taulant Balla. Një postim në "Facebook", Balla i kërkon Bashës që të mos bëjë më hetuesin e prokurorin, por të përgjigjet përse mbrojti kryebashkiakun e Mallakastrës. Sipas Ballës, është hera e dytë që Basha merr në mbrojtje "njerëzit e tij të kapur me presh në duar dhe është hera e dytë që refuzon të marrë përgjegjësi", duke shtuar se zbardhja e çështjes nëse Tahiri udhëtoi apo jo me Sotën i takon drejtësisë. "Lulzim Basha vazhdon të bëjë hetuesin, prokurorin, gazetarin dhe të mos i përgjigjet pyetjes pse e mbrojti kryebashkiakun e Mallakastrës, duke shkelur ligjin e tij 'të dashur' të dekriminalizimit për të dytën herë. Është hera e dytë që Lulzim Basha merr në mbrojtje njerëzit e tij të kapur me presh në duar dhe është e hera e dytë që refuzon të marrë përgjegjësi", shprehet në 'FB' z.Balla.



Në denoncimin e tij, kreu i PD-së, Lulzim Basha akuzon kryeministrin Edi Rama se po mbron Tahirin dhe po përpiqet të fshehin provat, ndërsa paralajmëron se të tjera të dhëna do të publikohen së shpejti.

FAKTET



Bylykbashi citon Falkonen: Ndiq paratë dhe do gjesh mafien

Pas sekustrimit të shi frave marramendëse të 835 mijë eurove dhe dy patentave në emër të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook", deputeti i Partisë Demokratike ka kthyer në vëmendje shprehjen e Gjovanni Falkones, i cili thoshte "ndiq paratë dhe do të gjesh mafien". Falkone ka qenë një ish-gjyqtar dhe ka gjykuar çështje të ndjeshme, por fundi i tij ishte tragjik, pasi e ekzekutuan në një atentat mafioz



në Itali. "Ndiq paratë dhe do të gjesh mafien (Gjovanni Falkone). Ndiq 863 mijë eurot dhe do të gjesh 5 milionet eurot në muaj. Patentat

janë vetëm si ato degët e thyera që të trëgojnë nga ka kaluar krimi", shkruan z.Bylykbashi në "Facebook".

ar bashkë për në Itali më datë 2 gusht 2016 nga Porti i Durrësit. Ata janë larguar nga Italia bashkë dhe janë rikthyer në Shqipëri më datë 7 gusht 2016 me të njëjtin linjë. 2. Më 1 shtator 2017, Tahiri dhe Sota janë larguar bashkë nga Shqipëria nëpërmjet Muriqanit dhe janë kthyer bashkë më datë 3 shtator 2017 po nëpërmjet Muriqanit. 3. Në 6 shtator 2017, Orest Sota ka dalë nga Shqipëria duke përdorur makinën e Tahirit.

Fakte të tjera tronditëse pritet të publikohen së shpejti. Edi Rama dhe qeveria e tij janë të zhytur në krim dhe të kapur nga krimi. Largimi i tyre është imperativ kombëtar". Kreu i PD, Lulzim Basha ishte i pari që denoncoi arrestimin e Orest Sotës katër ditë më parë. Orest Sota u arrestua më 2 nëntor në Elbasan me 863 mijë euro dhe dy patentat për mjetet lundruese në emër të Saimir Tahirit. PD thotë se eurot janë të Tahir-

it, ndërsa Orest Sota ka thënë në polici se po i çonte tek "Kurum" për të bërë një pagesë në emër të babait të tij biznesmen. Sa u përket patentave, Sota ka thënë se i harroi në makinën e tij shoferi i Saimir Tahirit, të cilin e ka shok. Ndërsa, për ish-ministrin e Brendshëm tha se nuk e njeh, kurse PD pretendon të kundërtën duke denoncur prova të lidhjes mes tyre dhe duke paralajmëruar fakte të reja në ditët në vijim.

AKSIONI OPOZITAR VENDIMET

"Opozita nis protestat kundër qeverisë, rrëzimi emergjencë kombëtare"

Kryemadhi paralajmëron marshime popullore: Përballje, ska më kohë

"Thirrja për socialistët e zhgënjyer: Bashkohuni me ne!"

Valentina Madani

Opozita e bashkuar do të nisë protestat në mbarë vendin si kundërpërgjigje ndaj lidhjeve të pushtetit me krimin e organizuar. Opozita synon rrëzimin e qeverisë "Rama" ndaj në funksion të kësaj, LSI mbodhi dje Konventën Kombëtare në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi" nga ku njoftoi nisjen e një marshimi politik për rrëzimin e sipas saj, të narkoshtetit dhe krijimin e një qeverie antimafie. Sipas drejtuesve të LSI-së, largimi i Edi Ramës është çështje javësh. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi e quajti emergjencë kombëtare rrëzimin e qeverisë dhe foli për një front kombëtar opozitar: "Gongu për këtë qeveri ka rënë", u tha Kryemadhi anëtarëve të Konventës. "Sfida jonë si një opozitë e përgjegjshme para qytetarëve tanë është që të mos përsërisim gabimet e dhimbshme të së kaluarës së errët. Është pikërisht kjo vetëdije kombëtare, që na duhet të zgjojmë në këto momente, për t'i dhënë frymë një misioni politik historik të mobilizimit të Frontit Kombëtar Opozitar" në betejën tonë të përbashkët qytetare, kundër krimit të organizuar në kupolën e narkoqeverisë dhe varfërisë, që kanë kapur prej fyti shqiptarët", - deklaroi zj. Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së foli për një marshim politik pa kthim dhe e quajti emergjencë kombëtare rrëzimin e qeverisë. "Nuk kemi më kohë për të humbur me retorikën politike, që bie në veshë e shurdhët të qeverisjes banditeske dhe as nuk do të presim paradën mediatike të fakteve të tjera tronditëse të skandaleve të radhës të kësaj mazhorance të kapur nga krimi dhe droga. Ne jemi gati të përballlemi. Ne duhet të shkundim apatinë kolektive për hir të interesit të përbashkët kombëtar kundër rrezikut", u shpreh zj. Kryemadhi. Njësoj si Partia Demokratike, edhe LSI kërkoi një qeveri antimafie dhe fton so-



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, dje Konventës

VENDIMI

"Emergjencë kombëtare është zhdukja e kriminelëve të paprekshëm dhe bandave të veshura me pushtet. Emergjencë kombëtare dhe shpëtim jetësor për qytetarët tanë është rrëzimi i kësaj qeverie të dalë boje në sytë e shqiptarëve e të botës dhe krijimi i një qeverie të re antimafie, që rikthen stabilitetin", - tha Kryemadhi.

"Tahiri", Vasili: Largimi i qeverisë, çështje javësh

Nga Konventa Kombëtare e LSI, ish-kryetari Petrit Vasili deklaroi dje se kjo parti është e njerëzve të kurajës së fortë. Ai tha se pushteti ka bërë përpjekje për të blerë me para të pista, por sipas tij LSI do ta zhdukë Ramën me të varfrit dhe të rinjtë. "Sot historia na ka vënë përpara një përgjegjësi të madhe, Rama të ikë, sepse ky kryeministër që ne kemi nuk ndahet sot nga krimi, sepse është organizatori dhe mësuesi i krimit dhe kriminelëve. Jemi misionarë dhe luftëtarë për ta ndaluar sot këtë kryeministër, që ka strategji të grabisë pasuritë e shqiptarëve. Jam këtu që t'ju them se pushteti është përpjekur të blejë me para të pista, por ai pushtet nuk do të blejë asnjëherë



njerëzit e ndershëm dhe zërat që janë kundër. Unë jam i bindur që ne do ta mundim të keqen, sepse paratë pista nuk e blejnë dot zemrën e bardhë të LSI. Ramën do ta zhdukim me të varfrit dhe të rinjtë. Rama ka shenja të një kapsllëku mendimi çdo ditë e më shumë, lajthitje



KLAJDA GJOSHA

Kauza jonë është vetëm një. Të vendosur për të ndarë politikën nga krimi. Ky nuk është vendi për të cilën shqiptarët kanë sakrifikuar jetët e tyre. Fatkeqësisht, Shqipëria nuk është vendi ku prindërit duan të rrisin fëmijët. Nuk është vendi ku rinia planifikon të ardhmen", tha zj. Gjoshja.

totale. Javë më parë në Kuvend paralajmërova se çfarë do të ndodhte, sot ju them se do të ketë të tjera zhvillime të rëndësishme, çështje javësh, që këtë kryeministër të degraduar do ta rrëzojnë nga pushteti", u shpreh kreu i deputetëve të LSI-së.

shura me pushtet. Emergjencë kombëtare dhe shpëtim jetësor për qytetarët tanë është rrëzimi i kësaj qeverie të dalë boje në sytë e shqiptarëve e të botës dhe krijimi i një qeverie të re antimafie, që rikthen stabilitetin, fu-



Presidenti Ilir Meta, dje gjatë ngjites në mal

LSI, RAMA: JEMI PËRBALLË KRIMIT QEVERTAR

Gjatë konventës së djeshme, zëvendëskryetari i LSI, Luan Rama, vuri theksin te lufta ndaj krimit, trafikut e korrupsionit qeveritar. "Jo krimi dhe jo qeverisjes së krimit. LSI nuk është vetëm dimension i qytetarit i opozitës, LSI nuk është vetëm zëri që artikulon qartë në opozitë interesin e qytetarëve, por LSI është shpirti, zemra e rezistencës shqiptare përballë të keqes, përballë krimit, trafikut dhe korrupsionit qeveritar", tha Luan Rama. LSI mbodhi dje Konventën Kombëtare për aksionin politik, që do të ndër-marrë pas ngjarjeve të fundit, referuar rastit të Tahirit që prokuroria e akuzon për përfshirje në dosjen e Habllajve.

REZOLUTA E LSI: BASHKËPUNIM OPOZITAR KUNDËR QEVERTISË NARKOSHTET

Konventa e LSI doli dje me një rezolutë me 8 pika nga dekriminalizimi, lufta kundër drogës, mbështetja e drejtësisë dhe bashkëpunimi me Partinë Demokratike. Sipas njoftimit të LSI: "Konventa mbështet Kryemadhin dhe forumet drejtuese, që të drejtojnë partinë në bashkëpunimin politik me parti, që janë të gatshme për një opozitë të qartë e pa kompromis kundër qeverisë së Rilindjes. Bashkimi bën fuqinë".

Rezoluta e LSI-së

1. Mandatohet kryetarin e partisë, grupin parlamentar dhe kryesinë e LSI, që të jenë në krye të betejës për dekriminalizimin e politikës, të luftës së hapur ndaj krimit të organizuar dhe trafikut të drogës.
2. Nuk do të pranohet asnjë aleancë me grupe apo individë në politikë, që kanë probleme me drejtësinë.
3. Mbështesim plotësisht kryetarin e partisë dhe forumet drejtuese të LSI që të drejtojnë partinë në bashkëpunimin politik me parti, aktorë të shoqërisë civile e faktorë të tjerë politikë e shoqërorë të të gjitha niveleve, që janë të gatshëm për një opozitë të qartë e pa kompromis kundër qeverisë së "Rilindjes". Bashkimi bën fuqinë!
4. Aleancat antikrim dhe antidrogë nuk mund të pengohen kurrsesi nga asnjë ndasi ideologjike. Vendimmarja politike e kryetarit e KDK dhe e kryesisë të përshatet në varësi të zhvillimeve konkrete politike në vend, por në asnjë rast të mos pranohet asnjë marrëveshje apo kompromis me bashkëpunëtorët e krimit të organizuar dhe drogës.
5. Kanabizimi i vendit dhe vendosja e Shqipërisë në hartën e trafiqeve më të rrezikshme ndërkombëtare të drogës është projekt me kriminal, me të cilin "Rilindja" nxu e damkosi vendin. Konventa e denoncon një zëri këtë projekt si antikombëtar, rrënues dhe të paparueshëm.
6. LSI e ka propozuar dhe mbështet fort dhe pa asnjë hezitim heqjen e plotë të imunitetit për çdo zyrtar të shtetit. Të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit.
7. LSI do të mbështet çdo prokuror, oficer të policisë gjyqësore apo gjykatës, që në bazë të ligjit kërkoi të hetojë politikanë të cillido subjekt e grupim politik, qofshin në mazhorancë apo opozitë.
8. LSI e konsideron bashkëpunimin me "Rilindjen" si të pamundur. Ai është një grup në funksion të interesave të krimit e drogës, të provuara këtu gjershtet. Bashkëpunim me socialistët e thjeshtë, por jo me "Rilindjen".

cialistët e zhgënjyer t'i bashkohen. "Ne si LSI e kemi marrë këtë vendim për të nisur pa kthim pas marshimin tonë politik" për të çliruar shqiptarët nga makthi i drogës, i krimit, i varfërisë, i papunësisë dhe pabarazisë dhe për t'u

dhënë atyre mbrapsht timonin e jetës së tyre, që pabesishit u është marrë peng nga kjo klikë e korruptuar dhe inkriminuar qeverisëse. Emergjencë kombëtare është zhdukja e kriminelëve të paprekshëm dhe bandave të ve-

qizon ekuilibrat e brendshëm ekonomik-socialë për më shumë mirëqenie, si dhe rikthen dinjitetin e Shqipërisë si një vend i NATO-s, që kontribuon në sigurinë e rajonit dhe jo si një vend eksportues i trafiqeve dhe kriminali-

titit", tha kryetarja e LSI. Kryemadhi bëri thirrje: "Koha tani të ngrihem i këmbë të nisim, marshimin e fitores së madhe, fitorja e shqiptarëve. LSI do të jetë në krye të çdo marshimi", - deklaroi zj. Kryemadhi.



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, zhvilluan një takim me shqiptarë që jetojnë në Janinë. Gjatë këtij takimi, të dy ministrat u ndalën te problematika dhe çështje, të cilat prekin drejtpërdrejt jetën e shqiptarëve jashtë atdheut. Ministri Bushati bëri një prezantim të investimeve të kryera nga Ministria e Jashtme përmes lehtësimit të procedurave për marrjen e disa shërbimeve përmes aplikimit 'online'. Ministri Bushati u ndal tek procesi i votës së emigrantëve, për të cilën falënderoi të gjithë shqiptarët, që deri tani kanë shprehur vullnetin e tyre me votë. Për ministrin, shqiptarët jashtë atdheut duhet të kenë një zë të rëndë-

Vota e emigrantëve, Bushati nga Janina: Do veprojmë me shpejtësi



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro gjatë takimit në Janinë

sishëm politik. "Për këtë arsye - tha Bushati, - qeveria shqiptare është angazhuar për të ngritur një sistem për lehtësimin e votës së emigrantëve. Ne kemi një angazhim politik si mazhorancë për të jetësuar të drejtën e votës për shqiptarët kudo ku ata jetojnë. Deri më sot, fakt është se ju kemi ardhur, dikush e ka pa-

sur afër, dikush e ka pasur mundësinë më të madhe ekonomike, dikush tjetër e ka ndërë si detyrim për të votuar sa herë që janë zhvilluar zgjedhje në Shqipëri. Ne duhet të veprojmë me shpejtësi, por edhe të krijojmë një sistem sa më të besueshëm, që vota e çdo shqiptari jashtë atdheut të garantohet dhe të

GARANCIA

"Ne duhet të veprojmë me shpejtësi, por edhe të krijojmë një sistem të besueshëm që vota e shqiptarëve jashtë atdheut të garantohet e të lexohet me drejtësi", - tha ministri Bushati.

lexohet me garanci dhe me ndershmëri" - tha Bushati. Për njohjen e kontributeve shoqërore, që është një tjetër problem për shqiptarët jashtë atdheut, ministri theksoi se, "jemi duke bërë të gjitha përpjekjet tona, por është një çështje tërësisht me karakter ekonomik".

"Task Forcë Speciale, goditje pa pushim deri në eliminim të rrjeteve kriminale"

TAKIMI



Ruçi, Spaho dhe Vasili, bashkë në Kosovë

Meftesë të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi nis sot një vizitë zyrtare dyditore në Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite, z. Ruçi do të shoqërohet nga kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla; kryetari i grupit parlamentar të PD-së Edmond Spaho dhe nga kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. Në këtë vizitë zyrtare në Kosovë, Ruçi dhe delegacioni që e shoqëron do të priten në një takim të veçantë nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, me të cilin do të ketë një konferencë për shtyp. Ruçi do të pritë edhe nga Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Haradinaj. Pjesë e axhendës së takimeve do të jenë edhe kryetarët e partive opozitare në Kosovë.

Vijnë agjentët e FBI, Rama: Plan sekret kundër krimit me kollare

"Ku bashkohem dhe ndahem me ambasadorin Lu"

Kryeministri Edi Rama njoftoi djë gjatë "Kommunikimit javor" nëpërmjet një videomesazhi se sot qeveria do të miratojë ngritjen e një Task Force Speciale në Policinë e Shtetit, e cila do të luftojë krimin dhe organizuar dhe korrupsionin e asistuar edhe nga agjentët e FBI, por edhe ekspertët tjerë nga Italia dhe Gjermania. "Nesër (sot) qeveria do të mblidhet për të miratuar ngritjen e një Task Force Speciale në Policinë e Shtetit për operacionin më afatgjatë dhe intensiv kundër krimit të organizuar. Një pjesë e kësaj strukture 'Forca e Ligjit' do të jetë sekrete dhe nuk do të ndahet me askënd, vetëm me agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare. Baza do të jetë me burime njerëzore vendësve dhe të huaja dhe aty do të jemi për të parë se kush e lufton dhe kush e mbrojnë krimin. Nuk do të jetë sekret operacioni policor, për të cilin është punuar prej 3 muajsh, për të çuar para drejtësisë kriminelët e skeduar nga Task Forca", - theksoi z. Rama.

STRUKTURA
Struktura e re që do të ngrihet do të godasë rrjetet kriminale, por shefi i qeverisë paralajmëroi furtunë edhe në radhët e politikës, pasi sipas tij, Task Forca do të godasë jo vetëm "kriminelët me patllake", por edhe



Kryeministri Edi Rama

INKRIMINIMI

"Në këtë vend do të ketë vetëm një vend për ata që janë mësuar të bëjnë përsesh ku kanë gjetur shesh dhe në atë vend do të shkojnë të gjithë. Mbyllje e epokës së pandëshkueshmërisë kriminale me 'kriminelë me patllake', por edhe të inkriminimit me kollare", - tha Rama.

dërguarve të tij që vijnë këtë javë në Tiranë, ambasadorit Lu që nuk jam gjithmonë dakord me çfarë thotë, por çfarë bën për Shqipërinë. Mirënjohës edhe qeverisë italiane, por edhe gjermane që kanë sjellë të dërguarin e tyre për operacionin 'Forca e Ligjit', - deklaroi z. Rama. Kryeministri paralajmëroi ardhjen e shpejtë të agjentëve të FBI-së. "Do të na bashkohen edhe agjentët tjerë të FBI-së dhe jo vetëm kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, që do të japin eksperiencën e tyre në Shqipëri. Do të luftojmë me krimin e organizuar dhe krimit ekonomik", deklaroi z. Rama.

DEKLARATA

Kryeministri foli edhe për deklaratat e ambasadorit amerikan, Donald Lu. Kryeministri u shpreh se me ambasadorin amerikan nuk është dakord me gjithçka çfarë thotë, por bie dakord me gjithçka që bën për Shqipërinë. "Me ambasadorin amerikan nuk jam dakord me gjithçka çfarë thotë, por jam dakord me gjithçka që bën për Shqipërinë. Do të na bashkohen agjentët tjerë të FBI-së kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, që do të japin eksperiencën e tyre në Shqipëri. Do të luftojmë me krimin e organizuar dhe krimit ekonomik", - u shpreh kryeministri Edi Rama.

IDRIZI: DO NGRIHIMI ME FORCË PËR ÇAMËRINË
Kreu i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi nuk është këtë legjislaturë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por pavarësisht ai thotë se beteja për çështjen çame do të vijojë. "Do të ngrihem në këmbë dhe me të forca për Çamërinë, dinjitetin e reciprocitetin ndaj kujtdo që mendon që mund t'i nëpërkëmbë shqiptarët", - shkruan Idrizi në "Facebook". Statusin Idrizi e shoqëron me një video nga pritja me protesta e ministrit grek Kotzias në 2016 në Tiranë. Kreu i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet nuk ka qenë aktiv në debatet politike pas 25 qershorit, ku nuk arriti të hynte në Kuvend.

"të inkriminuarit me kollare" majtas dhe djathtas. "Operacioni, ora e së vërtetës edhe për krimin e politikën. Do të shohim kush e lufton krimin dhe kush sulmon politikisht. Epoka e të fortëve që kanë përfitur nga prokurorë e gjykatës të korruptuar dhe shefa police të tredhur dhe skllëvër nga krimi apo politikë të shpallur të keqja duhet dhe do të mbyllet. Ky objektivi i shpallur që të

nesërmen e fitores së zgjedhjeve do të jetë fitore. Në këtë vend do të ketë vetëm një vend për ata që janë mësuar të bëjnë përsesh ku kanë gjetur shesh dhe në atë vend do të shkojnë të gjithë. Mbyllje e epokës së pandëshkueshmërisë kriminale me 'kriminelë me patllake', por edhe të inkriminimit me kollare", - u shpreh z. Rama.

VETINGU

Kryeministri u shpreh

shpresëplotë se me nisjen e vetingut, prokuroritë dhe gjykatat nuk do të jenë më kisha apo xhamia pa zot ku falen kriminelët. "Me nisjen e vetingut, prokuroritë nuk do të jenë më kisha apo xhamia pa zot ku falen kriminelët kudo qofshin, djathtas apo majtas. Më mbush me optimizëm edhe përfshirja e agjentëve të FBI-së. U Jam falënderues jo vetëm drejtorit të FBI dhe të

ANALIZA E HUMBJES

INTERVISTA

Valentina Madani

P është përfshirë në proces-analizë dhe konsultë të gjerë me të gjitha strukturat e saj pas humbjes së zgjedhjeve të 25 qershorit. Jamarbër Malltezi, anëtar i kryesisë dhe Këshillit Kombëtar të PD-së, është pjesë e grupeve të punës të shpërndara në terren dhe ndjek nga afër procesin në Tiranë. Malltezi thotë për "Gazeta Shqiptare" se situata në bazë është e vështirë, por sipas tij, demokratët po shihen në sy dhe po i thonë përballë të vërtetës. Z.Malltezi apelon për kundërpërgjigje ndaj 'pushta-shtetit', siç e quan ai, ndërkohë që vëren me shqetësim se një ndër pesë arsye të humbjes së zgjedhjeve ishte edhe mosangazhimi i funksionarëve të PD-së në fushatën e 25 qershorit. Jamarbër Malltezi flet për situatën kritike në vend, për shkak të lidhjeve të krimit me pushtetin, teksa shprehet se "pjesë e reflektimit është dhe besimi për luftën që kemi përballë me krimin e organizuar".

Z.Malltezi, PD-ja është përfshirë nga analiza e humbjes së zgjedhjeve, ndaj duke qenë se edhe ju jeni pjesë e grupit të punës në Tiranë, si e konsideroni situatën e brendshme në PD?

Partia Demokratike është përfshirë në një proces analize dhe konsultimesh me të gjithë anëtarësinë. Themeloria është që të shihemi në sy me njëri-tjetrin dhe të shohim përpara, pasi vendi ballafaqohet me një situatë absurde, mungesë shprese. Në pushtet nuk janë socialistët e thjeshtë, por krimi i organizuar, që cakton se kush do ketë monopole të drogës, kur dhe kush do të fikë radarët e ushtrisë, kush do ketë monopolin e tenderave në shëndetësi, infrastrukturë, deri edhe kush do ketë monopolin e prerjeve të pyjeve, etj. Përballë kësaj situatë, roli i opozitës është shumë vendimtar për të ringjallur shpresën në të ardhmen e vendit. Ndaj, pas udhëzimit të z.Basha, shumë anëtarë të Këshillit Kombëtar janë thirrur për të bërë analizë në bazë. Kjo nuk ka të bëjë me marrëdhënien mes individëve, por shikimin e njëri-tjetrit në sy, se përballë kemi një kundërshtar që përdor krimin e organizuar për të qëndruar në pushtet. Ne jemi në proces analize, në çdo qendër votimi na del se kudo kemi pasur blerje votash, natyrisht nuk është faktori i vetëm që të jemi të sigurtë, është një ndër pesë

"Në rrethe u blenë votat, në Tiranë humbëm për shkak të problemeve të brendshme në PD"

Malltezi: Funksionarë të lartë dëmtuan PD-në më 25 qershor

"Opozita, aksion kundër 'pushta-shtetit'"



Jamarbër Malltezi, anëtar i kryesisë dhe këshillit kombëtar të PD-së

GRUPET E PUNËS PËR ANALIZËN

■ TIRANË	Gert Bogdani, Jamarbër Malltezi, Ivi Kaso, Flamur Hoxha, Bujar Vukaj, Helidon Bushati
■ DURRËS	Bledi Kasmi, Ferdinand Xhaferri
■ ELBASAN	Kastriot Sulka, Erios Hoxha
■ FIER	Gazmend Bardhi, Ervin Minarolli
■ KORÇË	Arben Ristani
■ Shkodër	Kreshnik Çollaku
■ Kukës	Arben Ibroy
■ Berat	Eno Bozdo
■ Dibër	Jemin Gjana
■ Vlorë	Fartbardh Kadilli
■ Lezhë	Alfred Spahiu
■ Gjirokastrë	Florian Xhuti

faktorët kryesorë. Blerja e votës i bën zgjedhje allash-qiptarçe... Te blerja na dalin dy fenomene, parti të pushtet kanë blerë me paratë e tyre votën, por edhe fushata zgjedhore është përdorur si fushatë vjedhjeje

votash. Qeveria ka shkuar deri aty sa u ka thënë të varfërve "votoni për PS dhe s'do paguani faturë dritash për pesë muaj". Kjo është vjedhje shteti nga 'pushta-shteti'.

Ju po ndiqni në terren

ecurinë procesit të analizës dhe konsultimeve, por si po ecën ky proces?

Është shumë e rëndësishme që filloi si proces. Rezultati ishte zhgënjyes dhe çdo demokrat ka të drejtë të shfryjë dhe të na thotë të vërtetën në sy. Duhet të bëjmë maksimumin që secili të ketë mundësi të

HUMBJA

"Në zonat e varfra, blerja e votave me para droge del si shkak kryesor i deformimit të zgjedhjeve. Në zonat e pasura të Tiranës, më tepër dalin në pah problemet e brendshme të Partisë Demokratike, sidomos besimi apo puna sistematike në bazë dhe më pak emigrimi e punësimet pakmuore veç për të blerë vota", - tha Malltezi.

më tepër dalin në pah problemet e brendshme të Partisë Demokratike, sidomos besimi apo puna sistematike në bazë dhe më pak emigrimi dhe punësimet pakmuore veç për të blerë vota.

Sa ndikoi lista e kandidatëve për deputetë?

Mundet të jetë ndër faktorët që ndikoi në mungesën e besimit. Kjo, lidhur me mungesën e kritereve të qarta dhe mosangazhimit të ish-funksionarëve të Partisë Demokratike. Gjithsesi, në bazë më shumë ndikoi paqartësia me marrvëshjen Rama-Basha, që krijoi përshtypjen e bashkëqeverisjes dhe duke mos u sqaruar si duhet, shumë demokratë refuzuan të votonin për këtë bashkëqeverisje.

A ishte e dobët opozita në përballjen me PS-në e Edi Ramës?

Përballë një kundërshtari si Edi Rama, që nuk kishte mbajtur asnjë nga 41 premtimet pompoze të 2013-ës, fushata duhej të kishte qenë shumë më agresive dhe jo veç pak javë. Do duhej t'ua kujtonim shqiptarëve që Rama nuk po mban asnjë premtim, pasi po qeveris me krimin dhe paratë publike nuk shkojnë për të rritur mirëqenien e qytetarëve, por shkojnë veç në xhepat e disa oligarkëve me të cilët ai ndan paratë.

A ka një "gjallërim" të bazës së partisë pas fakteve të njëpasnjëshme, që implikojnë qeverinë me krimin, si rasti i përgjimeve e ardhura nga Italia lidhur me "Habibajt"?

Padyshim që u provuan tezat e opozitës për kanabizimin e vendit, për vendosjen e shtetit në shërbim të bandave të krimit të organizuar dhe konfirmuan pse 60% e shqiptarëve duan të ikin nga ky vend, që Zoti e ka bekuar. Këto bëjnë që qytetarët të trishtohen nga kjo qeverisje dhe ka më shumë frymë opozitare. Detyra jonë është të reflektojmë brenda vetes dhe të përballemi me të keqen që na sundon vendin. Pjesë e reflektimit është edhe rritja e besimit tek njëri-tjetri për rikthimin e shpresës.

E kam thënë edhe më parë, një ndër pesë problemet kryesorë të humbjes së zgjedhjeve është se fushata e PD nuk ishte aty ku duhet të ishte. Përballë një kundërshtari që nuk mbajti asnjë premtim, fushata duhet të ishte shumë më shumë agresive. Rama s'ka mbajtur asnjë premtim, ai

LISTA

"Lista mundet të jetë ndër faktorët që ndikoi në mungesën e besimit. Kjo, lidhur me mungesën e kritereve të qarta dhe mosangazhimit të ish-funksionarëve të PD-së", theksoi z.Malltezi.

thotë lirshëm mendimet e veta, të ballafaqojmë pikëpamjet, të gjejmë gabimet e ndodhura, me qëllim për t'i shmangur në të ardhmen. Deri tani jam i kënaqur që të gjitha takimet kanë qenë të hapura, të sigurt dhe me ndjenjë përgjegjshmërie. Do të shohim në vijim rezultatet.

Cilat janë shkaqet e rezultatit të dobët të PD-së?

Ka një mori faktorësh, pesë më të rëndësishmit duket se janë 1. blerja e votave, 2. kërcënimet e vendit të punës, 3. humbja e besimit, 4. gabimet në fushatën e opozitës dhe 5. emigracioni.

qeveris me krimin. Ne këto ia themi vetëm në konferencat për shtyp, gjë që nuk është e mjaftueshme. Unë jam për protesta të përditshme dhe me kontakt të përditshëm me elektoratin.

A janë kudo faktorët sipas kësaj renditjeje që ju përmendim?

Jo detyrimisht. Është e vështirë të përcaktohen në mënyrë sasiore faktorët e mësipërm, por qartazi ka një kombinim të tyre. Për shembull, në zonat e varfra blerja e votave me para droge del si shkak kryesor i deformimit të zgjedhjeve. Në zonat e pasura të Tiranës



Dogana e Kapshticës

Radhë të gjata në kufi, shkak defekti në sistemin TIMS

Kapshticë, ndalohej kalimi i shqiptarëve prej 2 ditësh

Një defekt në serverin qendror të policisë greke ka bllokuar prej 2 ditësh kalimin e kufirit për shqiptarët që nuk disponojnë pasaportë greke, ose të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian. Edhe pse ditën e shtunë situata u zhblokua

vetëm me skanimin e pasaportave, të dielën u rikthye i njëjti problem në pikën kufitare të Kapshticës. Mësohet se kjo situatë ka krijuar radhë të gjata në kufi. Gjatë ditës së shtunë u zgjidh përkohësisht kjo situatë pas ndërhyrjes së ministrit

të Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili kontaktoi me homologun grek Nikos Kotzias. Ministria e Jashtëm më herët sqaroi se sistemi kompjuterik u bllokua për shkak teknike. Ministri Bushati siguroi se ngjarja nuk ishte e qëllimshme. "Ka një

rënie të sistemit Shengen, që prek pikat kufitare që ka Greqia me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Turqinë, e kemi të verifikuar këtë gjë edhe me pikat e tjera", tha Bushati. Kjo situatë duket se u zgjidh përkohësisht ditën e shtunë, por të dielën u rikthye i njëjti problem, duke shkaktuar radhë të gjata në kufirin e Kapshticës. Qytetarët janë kthyer në kufi me argumentin se nuk punon sistemi TIMS. Autoritetet tona të kufirit nuk kanë asnjë njoftim nga pala greke se kur pritet të riparohet defekti.

Senad Nikshiqi

17-vjeçari: Hermes Beqiri më rrahu, më pas mora automatikun dhe e qëllova

SHKODER

Ka nisur si lojë për një kapele, por më pas ka përfunduar me vdekjen e një 23-vjeçari. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e së shtunë në Shkodër, kur në lagjen "Guerrile" në vendin e njohur si Ish-Zooteknika mbeti i plagosur rëndë shtetasi Hermes Beqiri, 23 vjeç. Beqiri gjeti vdekjen në orët e vona të ditës së djeshme, pasi qëndroi në gjendje të rëndë për jetën për disa orë, në spitalin e traumës në Tiranë. Menjëherë pas ngjarjes, policia e Shkodrës pas një aksioni të mirorganiuar arrestoi autorin e dyshuar të plagosjes, shtetasin Elvis Hoxha, 17 vjeç. Bashkë me të, blutë arrestuan edhe shokun e tij, shtetasin Ditmir Harifi, 17 vjeç i dyshuar si bashkëpunëtor në këtë ngjarje. Nga ana tjetër, Bekim Turishtia është arrestuar duke u akuzuar për "Moskallëzim krimi". Të rinjtë kanë qenë duke qëndruar në një lokal në Ish-Zooteknikën, kur mes tyre ka nisur debati për një kapele që ia kanë vënë njëri-tjetrit në kokë. Kaq është dashur që të rinjtë të konfliktohen. Pak çaste përpara plagosjes, mësohet se shtetasi Hermes Boriqi e ka rrahur 17-vjeçarin e dyshuar si autor. Ky i fundit ka shkruar dhe ka marrë një automatik kallashnikov. Është afuar tek dera e lokalit dhe nga aty e ka qëlluar 23-vjeçari

U zunë për një kapele, vdes 23-vjeçari shkodran

Në pranga dy autorët, sekuestrohet arma e krimit



Viktima, Hermes Beqiri

Hermes Beqiri ka mbetur i plagosur rëndë në vendin e ngjarjes. Menjëherë autori bashkë me shokun e tij janë larguar nga vendngjarja me motor.

Forcat e policisë kanë marrë informacion se 17-vjeçari fshihej në fshatin Frudë. Dhjetëra efektivë të drejtuar nga zëvendëshefi Saimir Rrustemi



Hetimi

POLICIA

Forcat policore arrestuan shtetasit E.H. 17 vjeç, banues në fshatin Golem, Shkodër, i dënuar më parë për veprën penale të "Vjedhjes" dhe D.H. 17 vjeç, banues në lagjen "Guerrile", Shkodër. Gjithashtu, është bërë i arrestimi për veprën penale "Moskallëzim krimi" i shtetasit Bekim Turishtia, 21 vjeç, banues në "Zogaj" Shkodër.

kanë shkruar në vendin ku fshihej. Pas pak minuta kërkimesh është arritur që të arrestohet, Elvis Hoxha, i cili mbante në dorë automatikun dhe fare pranë kishte edhe motorin me të cilin ishte larguar nga vendngjarja, që janë sekuestruar në cilësinë e

provës materiale. Pas arrestimit, 17-vjeçari Hoxha dhe shoku i tij, Ditmir Harifi janë dërguar në policinë vendore të Shkodrës për t'u marrë në pyetje mbi ngjarjen e ndodhur. **HETIMI**
Pas arrestimit, autori i dyshuar është marrë në pyetje

mbi ngjarjen e ndodhur në Ish-Zooteknikë. 17-vjeçari, i hutuar nga ana psikologjike nuk ka folur shumë, por vetëm ka treguar se shëri mes tyre ka ardhur për një kapele dhe se 23-vjeçari Hermes Beqiri e ka rrahur: "Ne jemi ngatërruar për një kapele. Nisi pak si lojë, por më pas situata u bë serioze. Aty ngritëm zërin dhe ai më rrahu. Më pas kam marrë automatikun dhe e kam qëlluar. Nuk kam dashur ta vras", mësohet të ketë thënë 17-vjeçari. Hermes Beqiri pas plagosjes është dërguar me urgjencë në spitalin rajonal të Shkodrës. 23-vjeçari ka marrë një plumb në bark, por trajektorja e plumbit i ka prerë disa organe duke bërë që të humbë një sasi të konsiderueshme gjaku, çka çoi në humbjen e jetës. Me dhjetëra persona kanë shkruar për të dhuruar gjak për të për të shpëtuar. Për rreth 8 orë 23-vjeçari ka qëndruar në sallën e operacionit nën kujdesin e veçantë të mjekëve. Më pas është transportuar me autoambulancë drejt spitalit të traumës në Tiranë për mjekim më të specializuar. Mësohet se Hermes Beqiri kishte dëmtuar legenin nga plumbi në trup. Të dy personat e përfshirë në këtë ngjarje të rëndë janë me precedentet penale të mëparshëm. Hermes Beqiri ka qenë i dënuar për vjedhje në plazhin e Veliqosë, ndërsa edhe Elvis Hoxha për vjedhje.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tenderi i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,970,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprkishtë pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttesha: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, deri më **datë 30 Nëntor 2017, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Lënda narkotike gjendet e mbështjellë në qese plastike

Policia italiane sekuestron 45 kilogramë marijuanë në Leçe, vinte nga Shqipëria

Një sasi prej 48 kg mar ijuanë është sekuestruar nga policia italiane në territorin e Vernolës. Mediat raportojnë se lënda narkotike është gjetur pranë bregdetit dhe vinte nga brigjet e Shqipërisë. Marijuana ndodhej pak metra larg detit, çka dyshohet të jetë nxjerrë në breg nga valët. Droga kishte përfunduar në zonën e plazhit, pikërisht në rezervatin natyror "Le cesine" dhe dyshohet t'u ketë rënë trafikantëve gjatë transportimit nga brigjet shqiptare. Lënda narkotike ishte e mbështjellë në qese plastike të lidhura me njëra-tjetrën përmes një tubi plastik. Policia vijon hetimet për të zbardhur ngjarjen e plotë dhe për të identifikuar autorët e marijuanës.

Shoqëria përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sipërfaqe 350 m², dhe sipërfaqe 191.9 m². (kati përfaqë 191.9 m², kati i 2 dhe kati i 3 me 269 m²) ndodhur në L. "11 Janari", ZK. 2310, Kuqovë, në pronësi Agim Isa Zeqja. Çmimi fillestar në ankandin e dytë është 11,200,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 09.11.2017, ditën e Enjte ora 15.30 në ambientin e Shoqërisë Përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.
Për info. Tel:045503458 ose E-mail shoqeriaepërbarimoreafa2010@gmail.com

Arsyeja e verifikimit, bizneset kanë deklaruar humbje ose fitime minimale

Zbardhen pasuritë e Çapjave e Çelajve në Elbasan

Nën hetim, biznese e prona të patundshme të dy fiseve

Pas hetimet të nisur nga Prokuroria e Elbasanit për 67 biznesmenë të regjistruar si subjekte tatimpaguese pranë atij qyteti, bien në sy emrat e dy familjeve më të përfulura në Elbasan, Çapja dhe Çelaj, për të cilat pritet të nisë verifikimin nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Policia e Shtetit dhe prokuroria do të nisin hetimet për biznese dhe shumë pasuri të patundshme. Në një denoncim që është bërë në Policinë dhe Prokurorinë e Elbasanit, të dyja këto institucione kanë referuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda materialet dhe në këtë dokument përmenden hotele dhe biznese, që dyshohet se u përkasin këtyre familjeve-citot "Report TV". Mësohet se në verifikim kanë kaluar pasuritë e Petrit Çelës, pronar i tregut agro-ushqimor. Pritet që Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Policia e Shtetit të nisin hetimet edhe për fisin Çapja për disa biznese që disponon. Verifikimet pritet të nisin edhe për faktin se në Drejtorinë e Tatimeve këto



biznese kanë deklaruar humbje ose fitime minimale. Hetimet ndaj këtyre dy familjeve në Elbasan vijojnë në një kohë kur një muaj më parë ndodhi përplasja mes policisë dhe shoferit të makinës "Audi", Enea Bekteshi, në hyrje të tregut agro-ushqimor. Pritet që në verifikim të

kalojnë pasuritë e familjes Çela, për bizneset dhe pronat e patundshme që disponojnë si shtëpi, vila, dyqane.

PASURITË E FISIT ÇAPJA
Sipas dokumentit në fjalë, për fisin Çapja do të hetohen disa nga bizneset si kompleksi "Univers" në Elbasan, i

cili është në pronësi të Ermira Çapjas, "Garden" hotel në Xibrakë në pronësi të Erion Mihallait. Gjithashtu, po hetohen disa apartamente në Elbasan, që mendohet se janë në pronësi të Florenc Çapjas, si dhe lokale në pronësi të Bledar Muçës. Në hetim janë edhe disa vila dhe

makina luksoze në emër të Enver e Fejzullah Çapjas si dhe Ambri Sinakollit. Sipas burimeve nga policia, gjatë aksionit "Vjeshtë 2017" po hetohen edhe pasuritë të patundshme në emër të Vladimir Çapjas, Erion Çapjas dhe Sajmir Serjanit. Konkretisht, pasuritë që fisi

Çapja disponon janë kompleksi "Univers", hotel "Garden", pronat e Florenc Çapjas, Lokalet e Bledar Muçës, vila të Fejzullah Çapjas, makina luksoze të Enver Çapjas, prona të Ambri Sinakollit, prona të Vladimir Çapjas, prona të Erion Çapjas, prona të Sajmir Serjanit. Këto pasuri të fisit Çapja, sipas burimeve, janë të vendosura në qytetin e Elbasanit, në Pogradec, por edhe në qytete të tjera, për të cilat po bëhet verifikim nëpërmjet Hipotekës. Familja Çapja figuron me një sërë rekordesh kriminale, pasi janë akuzuar shpesh për trafik droge edhe nga mediat e huaja, ndërkohë që në vitin 2016 iu bë një atentat anëtarëve të këtij fisi. Anëtarët e familjes Çapja në qershor të 2016-së kanë qëlluar mbi efektivet e policisë në qendër të Elbasanit, pasi i trembeshin një tjetër atentati. Prokuroria e Elbasanit ndërkohë ka nisur hetimet edhe për 67 persona të tjerë, të cilët dyshohen se kanë lidhje me familjen Çela.

TE DHENA

PASURITË E FISIT ÇAPJA

- ☉ Kompleksi "Univers"
- ☉ Hotel "Garden"
- ☉ Pronat e Florenc Çapjas
- ☉ Lokale e Bledar Muçës
- ☉ Vila të Fejzullah Çapjas
- ☉ Makina luksoze të Enver Çapjas
- ☉ Prona të Ambri Sinakollit
- ☉ Prona të Vladimir Çapjas
- ☉ Prona të Erion Çapjas
- ☉ Prona të Sajmir Serjanit

PASURITË E FISIT ÇELA

- ☉ Tregu agro-ushqimor
- ☉ Shtëpi
- ☉ Vila
- ☉ Dyqane

Në një konferencë të autoriteteve britanike në Londër për luftën kundër krimit është treguar se kriminelët shqiptarë në Britaninë e Madhe janë më të rrezikshmit. Këto banda rrëmbejnë të afërmit e grupeve rivale. Zyrtarët e lartë të policisë britanike kanë zbuluar se anëtarët e bandave shqiptare shënjestrojnë të moshuarit e familjeve të tjera të krimit, duke i mbajtur peng dhe iu kërkuar para, drogë apo territor në këmbim të lirim të tyre. "Zotërinjtë e krimit nga shteti i vogël ballkanik janë kaq të dhunshëm dhe të pashpirt, sa kanë uzurpuar bandat tradicionale të drogës në pjesën më të madhe të Anglisë, duke dërguar shuma të mëdha parash në vendin e tyre, teksa i fshehin në makina", raporton "Daily Mail". Duke i referuar shifra të fundit, kjo media shkruan se në Britani jetojnë 32 mijë shqiptarë, ku 572 prej tyre janë në burg. "Ju nuk mund të imagjinoni sa të pamëshirshëm janë ata.

Në Angli jetojnë 32 mijë shqiptarë, 572 prej tyre janë në burg

Bandat shqiptare terrorizojnë Britaninë, rrëmbejnë edhe të moshuarit



Disa prej bandave tradicionale janë shkrirë, përballë brutalitetit absolut të shqiptarëve. Këto janë padyshim bandat më të pamëshirshme që Britania e Madhe ka parë ndonjëherë. Ata rrëmbejnë të afërmit e moshuar të bandave rivale për t'i përdorur ata për të zhvatur paratë, drogën dhe territorin. Kjo krijon një shqetësim të madh për po-

licinë britanike", deklaroi Kathryn Holloway, komisionerë e krimit në policinë e Bedfordshire. Zonja Holloway gjithashtu tregoi se si policia kishte zbuluar se gangsterët shqiptarë po lëvizin "sasi të mëdha të parave" nga Mbretëria e Bashkuar në makinat e përshtatura posaçërisht. Më parë këtë vit, Vladimir Cahani dhe gruaja e tij, Ardita,

u kapën duke u përpjekur të kontrabandonin 130,000 euro të fshehura në mënyrë të posaçme në makinën e tyre. Kanë qenë qentë e forcave të kufirit të trajnuar posaçërisht për të zbuluar drogë dhe para, që kanë nxjerrë në shesh shumën marramendëse të parave. Agjencia Kombëtare e Krimit paralajmëroi pak kohë më parë se, "grupet shqiptare të krimit kanë krijuar një ndikim tepër të lartë brenda krimit të organizuar në Mbretërinë e Bashkuar". Shqiptarët janë furnizuesit më të mëdhenj të vendit me kokainë, si dhe të përfshirë në trafikun e qenieve njerëzore dhe prostitucion. NCA ka kryer 400 operacione kundër veprimtarive të tyre kriminale gjatë vitit të kaluar, duke synuar lavazhet e makinave, bare e bordello, ku bandat shqiptare detyrojnë bashkathetarët të punojnë.

SHKURT

Autobusi përplaset me një makinë në Librazhd, 6 të plagosur

LIBRAZH - Një aksident automobilistik ka ndodhur dje në aksin Librazhd-Elbasan. Mësohet se një automjet është përplasur me një autobus, ku për pasojë u plagosën 6 persona, mes tyre edhe dy të mitur. Ngjarja ndodhi në fshatin Mirakë. Si pasojë e përplasjes u plagosën pasagjerët e autobusit, shtetasja F.F., 52 vjeçe, banuese në fshatin Xhyrë, V.A., 31 vjeçe, E.A., 11 vjeçe dhe J.M., 6 vjeçe banues në Hotilisht, të cilët ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Po ashtu, të plagosur mbetën edhe drejtuesja e mjetit veturë, shtetasja A.K., 20 vjeçe, banuese në Elbasan dhe pasagjeri me inicialet B.P., 21 vjeç, të cilët u dërguan për ndihmë mjekësore në spitalin Kirurgjik Elbasan. Aksidenti solli edhe bllokimin e trafikut. Deri më tani nuk dihen rrethanat e ngjarjes.

Gjendet e vdekur pranë një parcele bujqësore një grua në Fushë-Arrëz

FUSHE ARREZ - Një grua në Fushë-Arrëz është gjetur e vdekur dje nga banorët, të cilët kanë njoftuar menjëherë policinë. Mësohet se viktimia është shtetësija Bardhe Paluca, e cila u gjet mbrëmjen e djeshme pranë një parcele bujqësore në Qafë Bosli. Nuk dihen ende shkaqet dhe motivet e ngjarjes, por paraprakisht viktimia nuk raportohet të ketë shenja dhune. Policia pasi mbërriti në vendngjarje, nisi menjëherë hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve dhe motiveve të ngjarjes.

Permbaresi gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shiltje ne ankand pasurine :
a) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 111/22, volumni 5, Fage 27, ne zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 5990 m2, e ndodhur ne adresen: Gur i Zi, Shkoder
b) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 114/56, volumni 7, Fage 48, ne zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 3492 m2, e ndodhur ne adresen Gur i Zi, Shkoder
1. Cmimi me te cilin do te filloje shiltja ne ankand eshte ne masen sic caktojme me poshte
a) per pasurite "Toke Are" me sip 5990 m2, eshte ne vleren 1,920,000 leke
b) Per pasurite "Toke Are" me sip 3492 m2, eshte ne vleren 1,400,000 leke
Shiltja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date: 14.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaresit gjyqësore Gentil Bushati me adresse Rruga Don Bosko, Portballe Gjakoves se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Permbaresi gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shiltje ne ankand pasurine :
"Apartament" me sip 127.7 m2, e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr 82 date 02.06.2011 me volumni 5 fage 108 me nr pasurie 16/130-1-8, ne Zonen Kadastrale 8597 me adresse, lagja "Pazare", Shkoder
2. Cmimi me te cilin do te filloje shiltja ne Ankand per pasurite e siperspikuar, eshte ne vleren 3,124,800 (tremilione e njeneqind e njezetakater mijë e tosetojd) leke .
Shiltja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date: 15.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaresit gjyqësore Gentil Bushati me adresse Rruga Don Bosko, Portballe Gjakoves se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr logarite 41064051, ose, ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Permbaresi gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shiltje ne ankand pasurine :
a) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 582/1, volumni 10, Fage 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3220 m2, e ndodhur ne adresen Barthullush Shkoder
b) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 523/21, volumni 9, Fage 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m2, e ndodhur ne adresen Barthullush Shkoder
1. Cmimi me te cilin do te filloje shiltja ne ankand eshte ne masen sic caktojme me poshte
a) per pasurite "Toke Are" me sip 3220 m2, eshte ne vleren 697,680 leke
b) Per pasurite "Toke Are" me sip 2360 m2, eshte ne vleren 509,760 leke
Shiltja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date: 08.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaresit gjyqësore Gentil Bushati me adresse Rruga Don Bosko, Portballe Gjakoves se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Fabrika e peshkut depoziton mbetjet dhe acidet në këtë zonë prej 5 vitesh

Kanali në fshatin Stajkë të Shkodrës, vatër infeksioni

Banorët: Shëndeti ynë është në rrezik

Voltiza Duro

Prej shumë kohësh banorët e fshatit Stajkë të Vaut të Dejës në Shkodër duhet të bashkëjetojnë përditë me mbetjet e hedhura në një kanal vetëm 50 metra larg shtëpive të tyre. Në një prononcim të dhënë për "Gazeta Shqiptare", ata tregojnë të shqetësuar se kjo situatë e padurueshme është kthyer në rrezik për shëndetin e banorëve që jetojnë në ambientin përreth. "Prej 5 vitesh fabrika e peshkut që ndodhet afër fshatit tonë i depoziton mbeturinat në këtë kanal. E për më tepër nuk hedhin vetëm mbetjet e peshkut, por edhe shumë acide që janë kthyer në një rrezik për ne. Kemi frikë se mos fëmijët afrohen te kanali e marrin ndonjë sëmundje", - shprehet i revoltuar njëri prej banorëve. Në fshatin Stajkë jetojnë mbi 2000 banorë, por më tepër nga kjo problematikë preken rreth 40 shtëpi, që ndodhen më afër këtij kanali, i cili është shndërruar në një vatër infeksioni. Familjet përreth tregojnë se para disa vitesh ky vend ka shërbyer jo vetëm për argëtimin e fëmijëve, por edhe si një burim për të kapur peshk. Por, sot nuk ka mbetur asgjë përveç



Kanal në fshatin Stajkë të Shkodrës

mbeturinave, që nga momenti në moment mund të shkaktojnë ndonjë epidemi për banorët e zonës. "Më parë ne, te ky mini-liqen mund të laheshim, të kapnim peshk dhe fëmijët e kishin si të vetmin argëtim

ku mund të luanin. Por tashmë ju mund t'i shikoni vetë plehrat që ka hedhur këtu fabrika e peshkut dhe stalla e derrave, që bëjnë biznes në këtë zonë. Peshqit nga acidet e mbetjet e shumta kanë ngordhur e



tregojnë se shpeshherë duhet të mbyllin dyer e dritare që të mos e ndjejnë aromën e keqe. "Çdo ditë e më shumë kjo erë po na merr frymën. Është e padurueshme, na duhet të mbyllim dritaret sepse po helmohemi, vjen një erë e qelbur. Të vihen në lëvizje përgjegjësit dhe të na japin zgjidhje, sepse do sëmundemi. Është një problem shumë i madh dhe askush nuk po e vë ujën në zjarr", - shprehet plot shqetësim një tjetër banor. Sipas tyre, fabrika e peshkut që ushtron aktivitetin në këtë zonë, shumë herë ka bërë pastrimin e pjesës së kanalit që është afër me godinën e tyre, por pjesa afër banorëve është lënë në mëshirë të fatit. Banorët e revoltuar u bëjnë thirrje instancave përkatëse që të marrin masat sa më shpejt të jetë e mundur për të zgjidhur përfundimisht problemin.

rueshme për familjet e Stajkës. Madje, ata që jetojnë rreth 50 metra larg kanalit

shëndeti ynë është në rrezik. Kërkojmë sa më shpejt një zgjidhje nga institucionet përkatëse", - tregon një tjetër banor për "GSH". Mbjetjet e depozituara në këtë kanal po shkaktojnë një erë të keqe e të padu-



Veliaj: Të ndërtojmë një aks qendror

Nikolla: Angazhim i mbajtur në buxhetin e 2018-ës

Premtimi, tekstet mësimore falas për nxënësit e shkollave 9-vjeçare për vitin e ardhshëm



het do të jetë në dispozicion të botimeve falas shkollore. Aktualisht Ministria e Arsimit mbështetet 18 kategori që përfshijnë familjet në nevojë, komunitetet si ai rom dhe egiptian si dhe familjet që kanë 3 dhe më shumë fëmijë në shkollë.

Propozimi për dhënie falas të teksteve shkollore ka ardhur edhe nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike nëpërmjet një amendamenti, të cilin e kanë dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë disa ditë më parë. "Shpenzimet për tekstet sh-

kollore dhe ato ndihmëse të nxënësve në arsimin publik nga klasa e parë deri në klasën e nëntën mbulohe plotësisht nga buxheti i shtetit. Tekstet shkollore të paguara nga shteti ka qenë një propozim i kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha prej kohësh. Shumë vende të rajonit e kanë këtë model, si dhe një pjesë e madhe e vendeve të BE. Tekstet falas për nxënësit do të ishin një ndihmesë për familjet e varfër shqiptare, që kanë një prej shpenzimeve më të mëdha të vitit blerjen e librave për fëmijët", - është cituar disa ditë më parë në njoftimin e PD-së. Në projektligj është theksuar gjithashtu se shpërndarja falas e teksteve mësimore do të krijojë mundësinë që të gjithë nxënësit të ndihen të barabartë dhe madje në këtë mënyrë do të lehtësohet edhe puna e mësuesit.

Nisin punimet për korsitë e biçikletave

Kanë nisur punimet për ndërtimin e korsive të dedikuara për biçikletat edhe në bulevardin "Zogu i Parë" në kryeqytet. Kryebashkiaku Erion Veliaj, i pranishëm gjatë inspektimit tha se ky investim do të përfundojë brenda këtij viti. "Jam shumë entuziast që projekti ynë i korsive dedikuar biçikletave po merr një përmasë tjetër, pra po del përtej zonës së qendrës. Po bëjmë një lidhje me sheshin 'Skënderbej' dhe me Bulevardin e Ri, për t'u siguruar që ishujt si sheshi i Bulevardit të Ri, sheshi 'Skënderbej', Pazari i Ri apo zona e Liqenit fillimisht lidhen mes tyre për të krijuar një rrjet minimal të biçikletave", tha Veliaj. Ai gjithashtu nënvizoi se me ndërtimin e këtij segmenti mundësohet krijimi i një aksit qendror të korsive për biçikleta, që nis në Kodrat e Liqenit dhe përfundon në Bulevardin e Ri. Kryebashkiaku shtoi se ambicia e Bashkisë së Tiranës është që të krijojë një rrjet sa më të madh të korsive të dedikuara për biçikletat, ku vetëm në fazën e parë parashikohen të ndërtohen 10 kilometra të tilla. Ndërkaq, Veliaj theksoi se me shtimin e këtij rrjeti të korsive të dedikuara për biçikleta, por edhe me kohën e favorshme që ofron Tirana, nuk ka më justifikim për askënd që të përdorë sa më shumë biçikletën si mjet lëvizjeje, jo vetëm si një mjet ekologjik, por edhe si një mënyrë për të mbajtur një fizik të shëndetshëm.

Opinion *i* Ditës

Leksion rreth radarëve që përdoren në ushtri

Nga Valbona Nathanailli

(Vijon nga faqja e parë)

... të vërtetë - argumentet lënë shumë për të dëshiruar. Por, megjithëse jemi të ndërgjegjshëm për gjendjen ku kemi arritur, këto burime vazhdojnë të luajnë rol, në mos për të përforcuar mendimin personal në lidhje me atë se çfarë ndodh, të paktën për ta peshuar gjykimin sipas një burimi tjetër informacioni. Dhe për të qeshur, a qarë! Kjo më ndodhi ndërsa ndiqja një prononcim të ish-ministres së Mbrojtjes në lidhje me parimin e punës së radarëve të "ushtrisë sonë", parim i cili kufizonte, - sipas saj, - edhe llojin e materialit që mund të identifikojë një radar: vetëm objekte metalike! Nuk e dija nëse duhej të qaja a të qeshja. Sipas ish-ministres, ndërsa përpiqej të shpjegonte pse ishin të fikur radarët në aksionet antidrogë, përpos të tjerave, solli edhe një argument tejet shkencor: "Edhe sikur të ishin ndezur, prapë nuk do të kishin asnjë dobi, sepse sikundër e dini, - theksoi ajo, - radarët zbulojnë vetëm objekte metalike, ndërsa gomoni që përdorin trafikantët dhe që janë prej gome nuk i identifikojnë dot". Buzëqeshja e ish-ministres shprehte keqardhje dhe mëshirë jo vetëm për paditurinë e panelit dhe të dëgjuesve, por sfidonte edhe të gjithë radarët që përdor ushtria italiane dhe të gjithë radarët e botës, të cilët që nga koha e shpikjes së tyre diku nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, kanë evoluar aq shumë, sa janë në gjendje të identifikojnë jo vetëm objektet metalike, por edhe në cilin drejtim lëviz, të themi, një zog, djathtas a majtas, largohet a afrohet.

Ishte gjenia e disa shkencëtarëve e shpikësve, duke filluar me gjermanin Hertz dhe britanikun Maksuell, që shfrytëzuan aftësinë që ka rrezatimi elektromagnetik për t'u pasqyruar nga një sipërfaqe metalike për të krijuar radarët, ose sikundër njiheshin në atë kohë me emrin e thjeshtë detektor (zbulues), në përpjekje për të shmangur përplasjet e anijeve gjatë lëvizjeve në kohë me mjegull a të turbullta. Ky tip i thjeshtë sot është aq shumë i përhapur, sa mund të blihet edhe në një dyqan të zakonshëm ose online dhe e përdorin, kryesisht, gjuetarët e thesareve. Sikundër ishte edhe "thesari" që zbuloi ish-ministria e Mbrojtjes në një emision të thjeshtë televiziv - radarët që ka ushtria shqiptare janë të kohës të qepës, gjithmonë nëse punojnë vetëm sipas parimit të mësipërm, pra të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë: sepse i vetmi justifikim për një deklaratë të tillë është vjetërsia dhe padobia e teknologjisë që ka në dispozicion ushtria jonë, pa dyshuar për asnjë rast në besueshmërinë e atyre që e këshillojnë ministren - në mos qoftë ndonjë 25-vjeçar që ka mbaruar për shkenca politike.

Sigurisht që shkenca në botë, në ndryshim nga ne këtu, ecën



përpara, sepse ka njerëz që e duan shkencën dhe politikën që bëjnë politika për zhvillimin e saj. Duke ju referuar përsëri botës, nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, këtij parimi - atij të pasqyrimin të valëve elektromagnetike nga një sipërfaqe metalike në funksionim e një radari, - i janë shtuar edhe parime të tjera, si ajo e ndryshimit të frekuencës së rrezatimit nga një trup në lëvizje, i njohur ndryshe si Efekti Dopler, po aq sa edhe ndryshimi i gjatë-

sive të valëve që përdoren, shogëruar me shumë lehtësi të tjera në gjetjen e përpunimin e informacionit që krijon teknologjia, gjithmonë në funksion të rritjes së fuqisë zbuluese të radarëve, po aq edhe të llojit të objekteve që mund të zbulohen prej tyre. Duke iu kthyer vendit tonë, në rastin e gomoneve, padukshmërisë, ose po të shprehemi në terma ushtarake, kamufllazhit natyror të tyre (këtu ka të drejtë ish-ministria), i shtohen faktet që

gjatë lëvizjes, vetë gomonia është burim zhurme, pra e identifikueshme nga lloji i tingullit që prodhon, motori është metalik, ndërkohë që njerëzit janë burim i një lloji rrezatimi që në fizikë njihet si infrarred, i cili emetohet nga trupat e nxehtë, sikundër është edhe trupi i njeriut. Të gjitha këto, si dhe shumë parime të tjera, por që nuk përbëjnë më arsye interesante në këtë shtjellim, i shndërrojnë radarët e sotëm, në llojin që ka shteti italian, pra të

dobishëm për të identifikuar lëvizjet e trafikantëve edhe me gomone. Dhe të domosdoshëm për të qenë gjithnjë në gjendje gatishmërie, pra ndezur.

Konkluzioni: do na pushtojnë trafikantët! Me kushtin që ta kenë parë emisionin dhe me kushtin që të mos qarkullojnë nëpër bregdet duke mbajtur ndonjë antenë të madhe parabolike. Thjesht, sepse vetëm atëherë mund të zbulohen nga ushtria jonë.



BLUE TOOTH

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA



te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me



MENAXHIMI I KRIZAVE



Hipertensioni,
në rritje numri i
të prekurve nën
moshën 40 vjeç

MAMOGRAFËT E LËVIZSHËM



Rreth 3 mijë
ekzaminime
në të gjithë
vandin

Albana Duni:

◆ Gastrohepatologia:
Shpesh mjekët e
injorojnë, duke e
përcaktuar si
"defekt kozmetik"



Mëlçia e dhjamosur, obeziteti shkaku kryesor

"Ja cilat janë medikamentet
që zhvillojnë sëmundjen"

• Konsumoni portokall kundër kancerit e presionit të lartë të gjakut

Gastrohepatologia: Shpesh mjekët e injorojnë, duke e përcaktuar si "defekt kozmetik"

Albana Duni:

Mëlçia e dhjamosur, obeziteti shkaku kryesor

"Ja cilat janë medikamentet që zhvillojnë sëmundjen"

Voltiza Duro

Steatohepatiti joalkolik, i njohur si NASH, apo mëlçia e dhjamosur ka filluar të haset shpesh në dyert e spitaleve në vendin tonë. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon se faktori kryesor i kësaj sëmundjeje është obeziteti. Sipas saj, kategoria më e prekur nga dhjamosja e mëlçisë janë femrat obeze me rritje të sasisë së kolesterolit në gjak, por edhe meshkujt e dobët. Mjekja thekson faktin që pacientët nuk paraqesin shqetësime të dukshme, por thjesht diskonfort abdominal. Ajo paralajmëron pacientët që të kenë kujdes, pasi nëse sëmundja nuk trajtohet, mund të progresojë deri në cirrozë brenda 5-10 viteve.

Çfarë është Steatohepatitis joalkolik?

Steatohepatiti joetilik ose joalkolik, i njohur si NASH, apo si dhjamosja e mëlçisë në gjuhën popullore është një sëmundje jo plotësisht e njohur në Evropë, por që haset shpesh në kushtet e shërbimit shëndetësor ambulator. Kjo sëmundje konsiston në grumbullimin e yndyrave në qelizat e mëlçisë. Pacientët, megjithëse e mendojnë, akuzohen për përdorim të tepërt të alkoolit. Nga ana tjetër, dhjamosja e thjeshtë e mëlçisë shpesh injorohet nga mjekët si "defekt kozmetik", gjë që nuk është tërësisht e saktë.

Sa i prekur është vendi ynë nga kjo sëmundje?

Mund të themi që ky entitet sëmundjeje haset relativisht shpesh në kushtet e shërbimit ambulator. Rastet e dyshuara që mund të ishin të

prekur nga kjo sëmundje ishin persona obezë, me rritje të nivelit të transaminazave dhe të kolesterolit në gjak, gjetje këto të rastësishme.

Cilat janë faktorët që ndikojnë në dhjamosjen e mëlçisë?

Faktorët më të rëndësishëm rrisht për dhjamosjen e thjeshtë të mëlçisë përfshijnë obezitetin, konsumimin e alkoolit dhe rezistencën insulinike. Ndërsa, prevalenca e dhjamosjes së mëlçisë në grupet e kontrollit është 16-20%, ajo arrin 46% në alkoolistët, 76% në personat mbi peshë, 95% në obezët alkoolistë. Këto gjetje sug-

nerohen nga dhjamosja e mëlçisë është më fort e shoqëruar me obezitetin sesa me përdorimin e alkoolit. Gjithashtu, rreth 80% e personave të prekur nga diabeti mellitus I tipit 2 apo ata që përdorin barna të caktuara janë të predispozuar për t'u prekur nga dhjamosja e mëlçisë.

Cilat janë disa prej barnave që ndihmojnë në zhvillimin e kësaj sëmundjeje?

Medikamente të lidhura me zhvillimin e NASH përfshijnë amfidarone, diltiazem, nifedipina, tamoksifen, estrogenet, glukokortikoidet. Vetëm agjentet antiaritmikë si amidarone janë një kërcënim sinjifikant që çon në



Cilat janë kategoritë më të prekura?

Femrat obeze përbëjnë 75% të pacientëve me NASH edhe në rastet që diagnostikohen në vendin tonë. Në qoftë se diagnoza e NASH është bazuar në kërkesat strikte për degjenerim yndyror, infiltrate inflamatore, ballonizim të hepatociteve, prezencën e trupave mallory dhe zhvillimin e fibrozës,



Gastrohepatologia Albana Duni

ansnjë rast në stadi të vonshme, pra në stadin e cirrozës.

Cilat janë stadiet e zhvillimit të kësaj sëmundjeje?

Histologjikisht janë identifikuar tri stadi të NASH. I pari është stadi i inaktiv ose forma joprogresive, që ka vetëm shenja minore të inflamacionit. Stadi i dytë është stadi subakut, ose subfulminant i NASH, i cili është i rrallë e zakonisht shihet pas procedurave kirurgjikale për reduktimin e peshës. Theksoj që ky stad është potencialisht fatal. Ndërsa stadi i tretë është ai kronik, që është forma me progresion të ngadaltë dhe më e shpeshtë, që i korrespondon më mirë pamjes klinike të NASH. Brenda këtyre tri stadeve ashpërsia e sëmundjes mund të kualifikohet në një shkallë gradash nga 1 deri në 4.

Çfarë ndodh nëse steatohepatiti joalkolik nuk trajtohet?

Në qoftë se NASH lihet i patrajtuar, do të progresojë në fibrozë, ose shpesh në cirrozë për 5-10 vjet në 10% të pacientëve. Disa studime e vendosin këtë shifër në një shkallë më të lartë se 40%. Rreth 12% e pacientëve, sidomos diabetikët, mund

të vdesin brenda 10 viteve nga komplikacionet e sëmundjes hepatike. Megjithatë, në një proporcion të madh të pacientëve, NASH ngelet benign dhe nuk progreson në stadiet e fundit.

Si kurohet NASH?

Ndërsye nga hepatiti C, deri më tani nuk gjendet terapi efektive për NASH. Kështu që qëllimi final i të gjitha masave terapeutike është ndalimi i progresionit të sëmundjes dhe në qoftë se është i mundur parandalimi i zhvillimit të cirrozës. Përderisa patogenezja e NASH është e panjohur, terapia mbetet empirike dhe kufizohet në trajtimin e gjendjeve të shoqëruara me NASH si diabeti mellitus, obeziteti dhe hiperlipidemia si dhe shmangien e agjenteve farmakologjike hepatoksike. Për kurimin e NASH, masa më e rëndësishme konsiston në reduktimin e peshës trupore. Pra, reduktimi i peshës trupore në rreth 10% të peshës fillestare të pacientëve është jashtëzakonisht i dobishëm në përmirësimin e parametrevë laboratorikë.

Hipertensioni arterial, i njohur si tensioni i lartë është një nga problematikat shëndetësore më të shpeshta të moshës së mesme. Mjekët e urgjencës thonë për "Gazeta Shqiptare" se menaxhimi i rasteve me hipertension arterial përfaqëson edhe një nga sfidat e përditshme në dyert e urgjencës mjekësore, pasi është rritur numri i rasteve. Madje, mjekët pohojnë se nga hipertensioni po preken edhe moshat nën 40 vjeç e një ndër shkaktarët është edhe stresi. Hipertonia arteriale klasifikohet si një nga shkaqet madhore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë kardiovaskulare. Në rreth 95% të rasteve hipertonia arteriale konsiderohet primare, ose parësore pasi nuk evidentohen shkaqe të dukshme të lindjes së saj.

Faktorët që ndikojnë

Janë disa faktorë ambientalë që ndikojnë në zhvillimin e hipertensionit arteriale. Vlen për t'u përmendur se obeziteti, përdorimi i alkoolit, stresi psikologjik, mungesa e aktivitetit fizik janë të gjithë faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe nxitjen e hipertensionit arteriale. Një rëndësi të veçantë i jepet edhe përdorimit të kripës në dietën ushqimore, ku studimet e bëra vërtetojnë se raporti ndërmjet kripës dhe hipertensionit arterial është një raport shkak-pasojë.

Simptomat

Përgjithësisht individët të cilët kanë probleme me hipertensionin arterial ankojnë si shenjë kryesore dhe më të shpeshtën dhimbjen e kokës, e cila është më e zakonshme në pjesën e pasme të kokës si dhe marrje mendsh apo errësim të pamjes. Në raste të manifestimit të këtyre shenjave, sidomos nëse janë të shpeshta, është e këshillueshme që të realizohet një kontroll shëndetësor. Vlerat normale të tensionit arterial variojnë nën 140mmHg (sistolik) dhe nën 90mmHg (diastolik). Ndërkohë që çdo vlerë e matur që rezulton mbi këto parametra konsiderohet Hipertoni Arteriale, që në varësi të rasteve klasifikohet si e lehtë apo e rëndë. Pikë së pari, një diagnozë përfundimtare e HTA-së duhet të bazohet në matjet e përsëritura të presionit arterial në momente të ndryshme.

Shkaqet dytësore

Ka plot raste kur Hipertonia arteriale është maskim i një problematike tjetër shëndetësore. Mund të përmendim këtu sëmundje të veshkës, diabeti, sëmundje të gjendrës



Stili i shëndetshëm i jetesës, domosdoshmëri për parandalimin e sëmundjes

Hipertensioni, në rritje numri i të prekurve nën moshën 40 vjeç

Menaxhimi i krizave kur rritet tensioni



tiroide, tumoret e gjendrës mbiveshkore etj. Prandaj sugjerohet gjithmonë që individët të kryejnë një ekzaminim të plotë fizik në rast se diagnostikohen me Hipertension arterial, në mënyrë që të përjashtojnë ndër të tjera edhe një shkak dytësor të tij.

Diagnostikimi

Nëse kemi një diagnozë, atëherë gjithmonë sugjerohet që të bëhet një vizitë në mjekun specialist. EKG e zemrës sigurisht është një ekzaminim që bëhet qoftë për të përjashtuar një komplikacion kardial, por edhe për të krijuar një ide

më të qartë nëse kemi një prekje të zemrës. Analizat biokimike sugjerohen përherë të kryhen dhe një rëndësi e veçantë u jepet vlerave të yndyrave dhe nivelit të sheqerit në gjak.

Mjekimi dhe stili i jetesës

Mjekimi i një Hipertonie arteriale konsiston në një kombinim antihipertensivësh të klasave të ndryshme, të cilat përkruhen nga mjeku specialist. Modifikimi i stilit të jetesës është një domosdoshmëri. Kufizimi i kripës, rënia në peshë, kufizimi i alkoolit, i duhanit, rritja e aktivitetit fizik janë

të gjithë elementë të rëndësishëm në kontrollin e gjendjes shëndetësore.

Krizat hipertensive

Kriza hipertensive është një situatë delikate, e cila kërkon një ndërhyrje të shpejtë mjekësore. Kjo, sepse komplikacionet e saj mund të jenë të rënda dhe vdekjeprurëse. Klinikisht shfaqet ajo që mjekësia e njeh si Encefalopati Hipertensive (dhimbje koke, alterim të gjendjes mendore, konvulsione). Mund të shoqërohet me gjendje të rënda shëndetësore si edemë pulmonare, infarkt akut i miokardit, disekacion i aortës etj. I sëmundur duhet të sillet domosdoshmërisht në urgjencë, nëse identifikohen shenja të tilla klinike, ku aty i jepet edhe ndihma e parë.



Sensibilizimi, "Europa Donna Albania" dhuron peruke për pacientet e prekura

MAMOGRAFËT E LËVIZSHËM, rreth 3 mijë ekzaminime në të gjithë vendin

Numri më i lartë i diagnostikimeve, në Lezhë

Në përfundim të "Tetorit Rozë", muajit të ndërgjegjësimit në luftën kundër kancerit të gjirit, Instituti i Shëndetit Publik ka publikuar listën e ekzaminimeve të kryera nga mamografët në të gjithë vendin. Në total, mjekët kanë kryer rreth 3 mijë ekzaminime brenda 2017-ës, ku numri më i lartë i tyre paraqitet në Lezhë, me plot 547 kontrole për kancerin e gjirit. Më tej, një shkallë të lartë interesimi ka pasur edhe në qytetin e Hasit, në të cilin 266 gra kanë bërë ekzaminimin e gjirit, për të vijuar me Pogradecin, me 254 ekzaminime. Ndërsa, numri më i ulët i ekzaminimeve ka rezultuar në zonën e Alliasit në Tiranë, me vetëm 11 të tilla. Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, edhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka organizuar një sërë aktivitete sensibilizuese. Ajo



gjithashtu ka ndërmarrë masa për luftën ndaj kësaj sëmundjeje.

Mamografia

Mamografia kap kancerin e gjirit në faza shumë të hershme e rezultati i

saj zakonisht merret mbas disa javësh. Për gratë që kanë kryer mamografi më parë, këshillohet të kenë filmat e tyre me vete për t'i lejuar mjekut të bëjë krahasimin. Nëse mamografia është normale,



duhet vazhduar bërja e saj sipas intervaleve kohore të rekomanduara. Kanceri i gjirit mund të shfaqet në çdo kohë, madje edhe nga një mamografi tek tjetra, prandaj mamografia duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe jo vetëm një herë. Nëse mamografia është e parregullt, nuk do të thotë gjithmonë se ka kancer. Për këtë duhet të bëhen teste shtesë dhe kontrolli nga një specialist i gjirit apo një kirurg.

Sensibilizimi

Në kuadër të ndërgjegjësimit në luftën kundër kancerit të gjirit, në Spitalin Onkologjik në Qendrën Spi-

talore Universitare "Nënë Tereza" u dhuruan paruke për pacientet, të cilat janë duke luftuar kundër kësaj sëmundjeje. Dhurimi u bë nga organizata jofitimprurëse "Europa Donna Albania", e cila ka për qëllim të ndihmojë gratë e prekura nga kanceri i gjirit. Paruket ishin të krijuara me flokë natyralë të vajzave dhe grave, të cilat kanë qenë pjesë e fushatës të nisur tashmë prej një viti "Dhuro flokë, fal shpresë" dhe që ka si qëllim dhurimin e flokëve për të krijuar paruke për gratë që janë duke u përballur me luftën e ashpër ndaj kancerin e gjirit.

EKZAMINIMET E MAMOGRAFISË TË KRYERA NË 2017 SIPAS RRETHEVE

■ Vlorë	79
■ Patos	217
■ Fier	66
■ Libofshë-Fier	199
■ Frakull-Fier	61
■ Lushnjë	231
■ Bërzhitë, Tiranë	15
■ Poliklinika 3, Tiranë	23
■ "Don Bosko", Tiranë	13
■ Allias, Tiranë	11
■ Kukës	192
■ Qendra Shëndetësore Farke	22
■ Has	266
■ Lezhë	547
■ Tropojë	132
■ Pogradec	254
■ Kuçovë	56
■ Biliisht	173
■ Fier-Frakull	104
■ Librazhd	130
■ Fier	107
■ Durrës- Kënetë	75
■ Tirane ISHP	11
■ Vlorë	36
■ Total	2987

Këshilla

Konsumoni portokall kundër kancerit e presionit të lartë të gjakut

Lëngu i portokallit është ndër lëngjet më të konsumuara, pasi ai ka një vlerë të madhe ushqyese për organizmin. Në bazë të studimeve që janë bërë, fruti i portokallit rezultoi i pasur me substanca që veprojnë kundër qelizave kancerogjene dhe luftojnë presionin e lartë të gjakut. Lëngu i portokallit është i pasur me vitaminë C, e cila ndihmon në forcimin e sistemit imunitar. Njerëzit, të cilët kanë probleme me presionin e lartë të gjakut duhet të konsumojnë rregullisht këtë pije,

pasi ajo ndihmon në uljen e tij. Hesperidina është një nga përbërësit më të rëndësishëm që përmban fruti i portokallit, pasi kjo substancë ndikon pozitivisht në sistemin kardiovaskular dhe ul nivelin e kolesterolit në gjak. Nivelet e larta të vitaminës C, që gjenden në këtë frut veprojnë si antioksidues. Rrjedhimisht, kjo do të thotë se me konsumimin e rregullt të lëngut të

freskët të portokallit parandalohet shfaqja e sëmundjeve të ndryshme, në mesin e tyre edhe kanceri i gjirit dhe i prostatës. Gjithashtu, portokalli ka veti antiinflamatore, pikërisht këto veti ndihmojnë në lehtësimin e dhimbjeve, në qoftë se keni probleme me artritin, ngurtësi të muskujve dhe nyjave. Studiuësit tregojnë se

antioksidantët në portokall ndihmojnë në humbjen e peshës. Një pije në ditë do të ketë ndikim pozitiv në metabolizmin tuaj dhe do të stimulojë humbjen e yndyrës. Gjithashtu, portokajtë janë një burim i acidit folik, që ndihmojnë zhvillimin e duhur të trurit. Ndërsa për gratë shtatzëna këshillohet që ky lëng i pasur të konsumohet rregullisht.



Ja sëmundjet që kurohen nga shega

Enditur në 10-shen më të mirë të frutave, shega evidentohej për vetitë e saj të fuqishme antioksiduese, në sajë të përmbajtjes së lartë të antioksidantëve si polifenolet. Këto të fundit janë mikronutrientë të rëndësishëm, që duhet të jenë pjesë e pandarë e dietës sonë ushqimore në të mirë të trupit dhe mendjes sonë. Në një studim realizuar në universitetin "Queen Margaret", Edinburg, Skoci, një grupi vullnetarësh iu dha nga një shegë për të konsumuar në ditë për 3 javë rresht. Pas 3 javësh iu dha nga një gotë lëng shege në ditë. U konstatua që ndjenja e tyre e urisë kishte ardhur duke u zbehur. Kështu që me të drejtë u ngrit hipoteza që polifenolet e shegës veprojnë si reduktues të urisë dhe si rezultat të krijojnë ndjesinë e ngopjes në stomak, duke evituar kështu ngrëniet e tepërta që çojnë në obezitet. Siç dihet, tashmë sëmundjet kardiovaskulare përbëjnë shkakun numër një të vdekjeve në mbarë botën. Origjina e kësaj sëmundjeje lidhet me nivelet e larta të triglicerideve dhe kolesterolit në gjak. Kështu, konsumi i shegës dhe lëngut të saj redukton në 4 javë nivelin e triglicerideve të larta në gjak si dhe rrit nivelin e kolesterolit HDL, i njohur ndryshe nga njerëzit si "kolesteroli i mirë".



Antioksidantët japin ndikimin e tyre në parandalimin e procesit të rritjes së qelizave kanceroze në disa lloje të kancerit të gjirit. Shega njihet për vetitë e saj antiinflamatore. Ajo bën të mundur uljen e intensitetit të proceseve inflamatorë në sëmundjet reumatizmale, duke zbehur simptomat e tyre tepër të dhimbshme. Konsumimi i frutës apo lëngut të saj të ndihmon në uljen e dhimbjes, edemave të artikulacioneve. Shega bën pjesë në shportën e ushqimeve të shëndetshme, që duhen të konsumoni gjatë jetës suaj, në mënyrë që të qëndroni sa më në formë dhe të rinj.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e dytë

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 3000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 3000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, për përfituesit e këstit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë

që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe

rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt

vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative". - thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E DYTË

(Vijon nga numri i djeshëm)

SH. ID. #	ARI POLITIK	TRASHËGIMTARËT E NIVELIT I		TRASHËGIMTARËT E NIVELIT II		DOKUMENTAT		KOPJE TË LETER NJOFITIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR	DËSHMI TRASHËGIMIE	PROKURE
		EMER	MBIEMER	EMER	ATESIA	EMER	ATESIA						
1272	Israhim	Israhim	497	Israhim	Israhim								
10357	Myftar	Duqi	230	Ali	Myftar	Duqi							
6895	Ramadan	Can	714	Maliq	Can								
16389	Thoma	Dede	61	Irakli	Dede								
14709	Jani	Ziu	61	Thanas	Ziu								
12425	Nikoll	Gjura	599	Olga	Gjura								
10972	Dedë	Gjura		Eliz	Gjura								

12710	Ismail	Cullhaj		Sulejman									
9447	Vangjel	Konomi	1069	Lazar									
12036	Mihal	Gjoka	297	Aleks									
13038	Isuf	Shehaj	196	Daut									
16086	Ilo	Kapedani	61	Llazi									
10497	Gjon	Lekaj	1069	Prek									
12326	Zef	Kukaj	707	Sokol									

Dosjet e kësaj periudhe të dytë, shqyrtuar deri më 26.09.2017

Table with columns for name, date of birth, and various status indicators (V, X, P, etc.). Includes entries for families like Gjin Macaj, Ljumbi Beka, and others.

Table with columns for name, date of birth, and various status indicators (V, X, P, etc.). Includes entries for families like Driç Kotovski, Driç Kotovski, and others.

Starova emërohet trajneri i ri i Partizanit

Iuliano-Partizani, vjen zyrtarisht "divorci"

Mark Juliano është shkarkuar nga drejtimi i Partizanit. Ish-mbrojtësi i Juventusit dhe i Kombëtares së Italisë e mori drejtimin e klubit kryeqytetas në korrik të këtij viti, ndërsa u shkarkua pas humbjes me Kamzën ditën e shtunë. Ndërkohë, Partizani ka njoftuar se në krye të stollit është rikthyer Sulejman Starova. Aventura e



Iuliano në Shqipëri zgjati 44-vjeçari e drejtori Partizanin në 9 javë kampionat, më pak se 6 muaj, ndërsa

ku siguroi 3 fitore, 2 barazime dhe 4 humbje. Me 11 pikë të akumuluar, Partizani është shumë larg Skënderbeut të vendit të parë, ndërsa me lojtarët e zhvilluara ka krijuar pakënaqësi te tifozëria, e cila është kundërvënë klubit dhe lojtarëve në mënyrë konstante. Në krye të stollit të kuq rikthehet një emër i shtëpisë. Sulejman Starova ka qenë edhe 2 herë të tjera trajner i Partizanit në epokën Demit, ndërsa është tekniku i fundit që ka shpallur të kuqtë e kryeqytetit kampionë në vitin e largët 1993.

KËRCËNIMI

Moxhi: Lojtarët kanë kohë deri në janar për të reaguar

Në një intervistë për "Supersport", drejtori i përgjithshëm i Partizanit, Luçiano Moxhi, shpjegoi edhe arsye për shkarkimin e Iulianos. "Folëm dhe morëm një vendim të rëndësishëm dhe arritëm në përfundimin që nga java e ardhshme, Iuliano nuk do të jetë më trajneri i Partizanit. Në vendin e tij do jetë Starova, i cili e njeh mirë kampionatin, i njeh edhe lojtarët që ka në dispozicion. Iuliano ka pasur mungesë në rezultate. Kishte fatin e keq që Çani nuk mund të aktivizohej, më pas u dëmtua edhe Sukaj. Duhet ndryshuar një trend për më shumë forcë tek ekipi. Në janar, ata që do ia dalin ta shpërblejnë besimin, do qëndrojnë; në të kundërt të tjerët do largohen", - deklaroi Moxhi.

Skënderbeu thyen Vllazninë pastër 2-0, duke siguruar fitoren e 8-të sezonale

Skënderbeu nuk njih lodhje, vijon 'vrapin' në krye të tabelës

Taku dhe Soue u japin tri pikët korçarëve



Jeton Selimi

Pas një sfide me aq shumë ngarkesë fizike dhe emocionale, si ajo kundër Partizanit të Beogradit, rivalët e Skënderbeut shpresonin shumë që korçarët të ndaleshin në javën e 9-të. Vllaznia ishte kundërshtari ideal për t'i dhënë fund pushtimit të Skënderbeut, por në fund individët e Ilir Dajës bënë sërish diferencën. Taku dhe Ali Soue shënuan nga një gol në pjesën e dytë, duke siguruar fitoren e 8-të sezonale. Skënderbeu mori shumë shpejt kontrollin e lojës, duke qarkulluar saktë dhe shpejt topin, por nuk ishte të tillë në pasin final. Në pamundësi për të gjetur hapësira në mbrojtjen e ngjeshur të Vllaznisë, korçarët u përpoqën t'i jepnin zgjidhje ndeshjes me goditje nga distanca, si në minutën e 13-të me Lilajn. Në zbritjen e parë të rrezikshme në portën e Shehit, Vllaznia ishte kërcënuese dhe shumë e pafat. Gilman Lika hodhi një kros perfekt në qendër, por Carls Atsian nuk arriti të

SUPERLIGA		
JAVA E 9		
TË SHTUNËN		
Lufëtari-Lushnja		2-0
Kamza-Partizani		1-1
Teuta-Laçi		1-0
TË DIEËN		
Skënderbeu-Vllaznia		2-0
Flamurtari-Kukësi		1-1
Skuadra N P		
Skënderbeu	9	25
Kukësi	9	18
Flamurtari	9	16
Kamza	9	15
Laçi	9	11
Partizani	9	11
Teuta	9	8
Lufëtari	9	8
Vllaznia	9	6
Lushnja	9	5



minutën ishte radha e Skënderbeut t'i afrohej golit të avantazhit. Afrim Taku mori një asist të pavullneshëm nga Krymi, por gjuan keq me Selimajn që largon me këmbë. Dy ekipet zhvilluan një futboll agresiv gjatë pjesës së parë, duke luftuar fort për çdo top, një fraksion loje me shumë stacione, që zbehu jo pak bukurinë e një ndeshje shumë delikate. Vllaznia ishte kërcënuese edhe

me fillimin e pjesës së dytë, ku Carls Astina me shpejtësinë e tij u kthye në problem për mbrojtësit e Skënderbeut, por sulmuesi afrikan humbet kohë duke gjetur vetëm trupin e Shehit. Në minutën e 50-të ishte Xhejms, ai i cili solli pëshënjellim në zonën e shkodrane, ku mes shumë fanellave të Vllaznisë gjen hapësirë për të goditur, por Selimaj në dy kohë kontrollon gjithçka.

ja e tij shkon ngjitur me shtyllën pingule. Vllaznia nuk hoqi dorë nga dëshira për të dalë me pikë nga kjo transfertë e detyruar, por në minutën e 80-të ishte Nimag, ai i cili i hoqi mundësinë për të shënjestruar kuadrantin e Shehit. Skënderbeu shfrytëzoi në maksimum çdo detaj të këtij takimi dhe ishte me shumë fat si në golin e dytë në minutën e 84-të, ku Ali Soue devijoi në mënyrë të pavullneshme topin, që më pas iu kthye në asist duke shënuar golin e dytë për Skënderbeut, një fitore shumë e rëndësishme që përforcon edhe më shumë statusin e korçarëve si dominues të futbollit shqiptar.

MBYLLET NË BARAZIM 1-1

"Paqe" në Vlorë mes Flamurtarit dhe Kukësit

Flamurtari dhe Kukësi janë ndarë në paqe në takimin e fundit të vlefshëm për javën e 9-të të Superiores, ndërsa ky barazim i bën më shumë punë Skënderbeut, që tani e sheh veten në +7 pikë nga Kukësi i vendit të dytë. Në stadiumin "Flamurtari" luhej pa praninë e tifozëve, për shkak të dënimit dhënë nga disiplina, por gjithsesi tifozët vlonjatë nga jashtë stadiumit arritën të hedhin sërish kore kundër federatës dhe presidentit të saj, Armand Dukës. Golin e parë në këtë sfidë do ta shënojë Kukësi, kur Elis Bakaj me zgjuarsi e krekutun një goditje dënimi në minutën e 37-të, duke e kaluar topin poshtë murit mbrojtës dhe duke befasuar portierin Nurkoviç. Flamurtari bëhet më kërkues në pjesën e dytë, por më parë do të jetë Ethem, që mund të mbyllte takimin në minutën e 64-të, por do të ndalet nga gardiani i përfaqësueses së Kosovës. Kuqezinjët do ta gjejnë golin e barazimit në të 73'-ën, kur Zhufio harkon në zonë dhe Bushiç me kokë thyen Koliçin. Në fund të ndeshjes Flamurtari do të shënojë një tjetër gol, por që do të anulohet nga gjyqtari Hamiti. Mbyllet 1-1 në Vlorë me Kukësin, që ngjitet në 18 pikë dhe Flamurtari në 16.

Replika e trajnerit


Daja kundër Gjicit: Skënderbeu nuk ka aleatë

Në intervistën pas ndeshjes me Vllazninë, trajneri Daja u shpreh se mungesat në formacion e bëjnë më të vështirë rotacionin për Skënderbeun. Gjithashu, ai shtoi pas akuzave për aleatë në kampionat, se korçarët nuk kanë asnjë të tillë në kampionat. "Synimi ishte trepikëshi, që e arritëm. Mund të luanim më mirë, por lodhja bën të vetën. Nuk mund të bëjmë shumë rotacione. Qëllimi për



ishte fitorja dhe e arritëm. Ekipi tregoi mentalitet fituesi, edhe pas lodhjes së kësaj jave. Ne nuk kemi pasur aleatë, as këtë vit as një sezon më parë. U bë zgjedhja më e mirë, pasi u krijoi lojtarëve mundësi të luajnë në një terren sa më mirë. Në këtë moment mund të duket si një bonus për ne, por ndeshja në një fushë sportive nuk është në të mirë të askujt. Ndeshjet që sot i kemi brenda, nesër do kthehen në transfertë për ne".

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
 1. Steiger aktor.
 4. Mbetet në fund.
 6. Ustinov i kinemasë.
 11. Janë në modë.
 12. Nuk e shqyen Danielin.
 15. Një as i Milan.
 16. Çobani aktore e jona.
 18. I dyti në kapitull.
 19. Dy asa në dorë.
 21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
 23. Croft e Angelina Jolie.
 24. Një që mbahet për mondan.
 25. Para De Janeiro-s.
 27. Gjysmë tandem.
 29. Kap ndryshe.
 30. Gjysmë tatimi.
 31. Union Studentor Operativ.
 33. Wallach aktor.
 35. Pak spiunazh.
 37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
 38. Ai dhe ajo.
 40. Një Madame e Maupassant.

41. Kështu thirrej Ernesto Guevara.
 42. Fund ditari.
 43. Pije piratesh.
 45. Kush e thotë refuzon.
 46. Të parat në sondazh.
 47. Një makinë franceze.
 48. Fillojnë stafetën.
 49. Nisin nga fillimi.
 50. Qan të Turandot.
 51. Fundi i një samurai.
 52. Umberto qe shkroi Lavjerësi i Foucault.
 53. Dalë në krye.


- VERTIKAL**
 1. Ajo e tretë u quajt Moskë.
 2. Në hyrje të odës.
 3. Me mea për të penduarin.
 4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
 5. Jepet për hartim.
 7. Lindi edhe Cerberin.
 8. Mbyllin pora.
 9. Gjysma e ekipit.
 10. Një inkursion me mig.
 12. Fillojnë lehtë.
 13. Eshhtë tretës me zorrë.
 14. Pak tematike.
 17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
 20. Eshhtë ndalim me pranga.
 22. Shkroi Këngëtarja tullace.
 23. Eshhtë pikë vaji.
 26. Ndajnë shtetet.
 28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.
 32. Poetja e Lesbos.
 34. Kështu shprehet komisar Rex.
 36. Fillojnë panikun.
 38. Një liqen i kripur.
 39. Inva soprano.
 43. Inicialet e Altman
 44. Një fjalë për sipër.
 46. Të parat në stadium.
 47. Fillojnë turmin.
 48. Në hyrje të sokakat.
 49. Fillojnë nazet.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
 3. Një pune... paguhet.
 6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
 8. Vincenzo, bomber te Roma.
 12. Kufijtë e pritjes.
 13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
 16. Demek s'ka kufij.
 19. Qe filozofi i shkollës eleatike.
 21. Nino, kompozitor i famshëm italian.
 21. Eshhtë ai që ka ngrityr krye.
 23. Finlanda e... finlandezëve.
 25. Mbledhë basketë separatistë.
 26. Inicialet e Prost.
 28. Shkroi Cocktail party.
 29. Titulli i Alex ferguson.
 30. Stile pa kufij.
 32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
 35. Unë dhe ti.
 36. Hoxha që qe arbitër.

38. Eshhtë provë zjarri.
 39. Majtas në fund.
 41. Agjenci Ajrore Tiranë.
 42. Eshhtë partia e Ariel Sharon.
 43. Një mund të jetë ciklistik.
 45. Të parat në sondazh.
 46. E famshme ajo e psherëtimave.
 47. Qendër ditore.
 48. Një Baba përallor.
 49. Mund të jetë proteste.
 50. Në fund të fundit.


- VERTIKAL**
 1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.
 2. Në krye të soistëve.
 3. Janë poetë si Ungaretti.
 4. Ylli më i shndritshëm i Demit.
 5. Janë kopjet si delja Dolly.
 7. Një pjesë e dimensioneve.
 8. Fillojnë muzikën.
 9. Parafjala e prejardhjes.
 10. Fernando, bomber i Liverpool.
 11. Bisha aktore.
 12. Ishin ushtarë të Kserksit.
 14. Partia Demokratike.
 15. Cepat e një ylli.
 17. Ylli i baletit.
 20. Pak amoralitet.
 22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
 24. Italia në Internet.
 27. Përhapet me frikë.
 31. Mund të jetë françeskan.
 33. Dehin pa kufij.
 34. Eshhtë lënda për... rafte.
 37. Gjysmë sahati.
 39. Tatum që qe pianist.
 40. Lloj papagalli.
 42. Një pikë vaji.
 44. Artikull spanjoll.
 45. Në krye të socialistëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

ARMAND LINDA
 VAJI EM VEK
 ADEEN LAK E OAZ E
 TATAK MI LIT ANT E T
 RA PIRAMI D A L E T
 RA F IN E R I T E E L
 FA N A T I K E T H I
 DE N A R A E G E G
 E A J E H E R O N J
 MA R I A N A P I N E D A A
 E T E R A E T I K E T A A
 KA T A R A K T T A T I M

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik

Argëtim filozofik

SUDOKU

				5			7	
	9	6		2		1	8	
2		4	1	3		9		
6	3	5	9				1	
	4						2	
	1			3	6	7	9	
		8		6	7	5		1
	6	7		4		8	3	
3			2					


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	9	4	6	7	8	5	3	1
1	5	6	4	3	9	2	7	8
3	8	7	1	2	5	4	6	9
5	6	2	7	8	3	1	9	4
9	3	8	2	4	1	7	5	6
7	4	1	5	9	6	3	8	2
4	7	5	9	6	2	8	1	3
8	1	9	3	5	4	6	2	7
6	2	3	8	1	7	9	4	5

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



S U P A I K K U R S I
 A P E R A T U R A H K
 T T O P A T P A P A S
 K E M A L T A K A I
 P A R E T I T R U R I
 R P I A M E L I A S
 E T A T E T L S H
 P O N Y E R I I U T
 I L T Y M I E M K E
 T I R A N E T R I M A T
 E N T I T A N I K E E
 T A U E T K U R A T

Argëtim filozofik

- Fjala "krizë", në gjuhën e shkruar kineze, përbëhet nga dy simbole. Njëri përfaqëson rrezikun, dhe tjetri përfaqëson mundësinë.

(Xhon Kenedi)

- Nëse doni që diçka të realizohet shkoni vetë, nëse nuk doni, dërgoni të tjerë.

(Benxhamin Franklin)

- Fundi i madh i jetës nuk janë njohuritë, por veprat.

(Tomas Fuller)

Thënie të mënçura

- Nuk kalohet jeta duke dhënë spjegime, pasi miqtë e tu nuk kanë nevojë për to, armiqtë nuk të besojnë ndërsa budallenjtë nuk të kuptojnë.
- Askush nuk mund të kthehet prapa dhe të ketë një fillim të ri, por çdokush mund të fillojë sot dhe të ketë një fund të ri...
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbacov)
- Një njeri s'mund të ndihet realist mirë, në rast se nuk aprovon vetveten. (Mark Tuein)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

